



Fakulteti i Ekonomisë
Studime pasdiplomike - Ekonomi ndërkombëtare

PUNIM MAGJISTRATURE

*“Zhvillimi i NVM-ve dhe ndikimi i tyre në rritjen
ekonomike të Pollogut”*

Mentori:

Prof. dr. Nasir Selimi

Kandidati:

Antigona Rustemi

Tetor , 2020

PËRMBAJTJA E PUNIMIT

Qëllimet e hulumtimit	5
Hipotezat	6
Rëndësia e punimit.....	7
KAPITULLI I 2	8
Hyrje	8
1. Rishikimi i literaturës.....	10
1. Qasja teorike dhe definimi i problemit.....	11
3. Përkufizimi i NVM-ve	14
4.Probleme të përkufizimit të NVM-vë	16
5. Roli dhe rëndësia e ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme në zhvillimin ekonomik	17
6. Informacioni Background rreth ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme	19
7. Financimi i aktiviteteve afaristë të NVM-ve në Rajonin e Pollogut	20
KAPITULLI I 3	23
1. Financimi i NVM-ve në Rajonin e Pollogut	23
2. Financimi i NVM-ve në vendet e zhvilluara dhe në vendet e rajonit	24
3. Veçoritë e financimit të NVM-vë në Rajonin e Pollogut.....	25
KAPITULLI I 4	27
1. Burimet e financimit të NVM-vë në Rajonin e Pollogut	27
2. Sistemi tatimor në funksion të zhvillimit ekonomik të NVM-vë në Rajonin e Pollogut	28
3. Ndikimi i NVM-vë në rritjen ekonomike.....	30
4. Ndikimi i NVM-ve në importin	35
5. Ndikimi i NVM-vë në export.....	36
KAPITULLI I 5	38
1. Analiza e raporteve vjetore të mara në Komunën e Tetovës dhe Zhelinës për hapjen e ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme në Rajonin e Pollogut për periudhën 2010-2020	38
2. Metodologjia.....	39
3. Metoda kualitative – biseda të lira me analist të ekonomisë që flasin rreth ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme	41
4. Metoda kualitative – biseda të lira me profesor universitar në Drejtimin Ekonomik – Universiteti i Tetovës dhe Universiteti i Europës Juglindore.	42
a) Analiza komperative midis Shqipërisë, Kosovë dhe RMV	45
Përfundimi.....	58
Bibliografia	64

Falenderime

Së pari, falenderimi i takon Zotit të Madhëruar ndaj të cilit përulem me krenari.

“Edukimi është gjëja më e mirë që një baba mund t’i jep fëmijës së tij – Muhamedi a.s.”

Falenderoj thellësishtë dhe u jam mirënjohëse përjetësisht dy personave më të veçantë në jetën time të cilët ishin afër meje në çdo hap të jetës sime duke më ofruar mbështetje të pa kusht emocionale dhe financiare.

Falenderoj babain tim, dhe nënën time, të cilët besuan dhe më përkrahën në çdo sukses timin. Një falenderim tjetër të përzemërt ia dedikoj burrit tim.

Poashtu, falenderoj familjen time të gjerë të cilët në mënyra të ndryshme e lehtësuan punën time. Së fundmi, por jo për nga rëndësia, falenderoj shoqërinë time për këshillat dhe përkrahjen e vazhdueshme, jam me fat që janë pjesë e jetës sime.

KAPITULLI I 1

1.1 QËLLIMET E HULUMTIMIT

Punimi mendohet të ketë një rëndësi të veçantë. Është një punim i cili do të trajtojë tematikën e ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme në Rajonin e Pollogut. Bizneset e vogla paraqesin një faktor vital të zhvillimit në secilën ekonomi.

Ata më së shpeshti i zhvillojnë individ të cilët posedojnë aftësi prodhuese dhe një shpirt kreativ. Përvoja në tregjet ekonomike tregon se në shumë degë të industrisë si dhe në tregtinë, ndërmarrjet e vogla janë më të adaptueshme në ndryshimet tregtare nga ndërmarrjet e mëdha, dhe në një kohë lajmërohen si inovatorë të produkteve të reja, shërbimeve dhe teknologjisë. Shumë inovacione të mëdha dhe të rëndësishme shpeshherë rrjedhin prej ndërmarrjeve të vogla.

Ndërmarrjet e vogla, apo novatorë, i kanë krijuar kompjuterët personal, radion, motorët me avull, fotokopjen, aparatit fotografues dhe shumë inovacione të tjera.

Qëllimi i këtij punimi është analiza e ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme në Rajonin e Tetovës duke analizuar pikërisht financimin e këtyre aktiviteteve afariste në vendin tonë. Po ashtu do të realizojmë një komperativë me vendet e zhvilluara për rreth. Po ashtu do të analizojmë edhe vecoritë e finansimit të ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme.

Qëllimi im është të japë një panorama të plotë të përkufizimeve dhe koncepteve që përdoren për ndërmarrjet e vogëla dhe të mesme.

Objektiva e punimit:

- 1. Do të mundohemi të realizojmë identifikimin e koncepteve që përdoren për të shprehur konceptin e ndërmarrjeve të vogëla*
- 2. Të realizojmë identifikimin e burimeve të financimit të këtyre ndërmarrjeve në Rajonin e Pollogu.*
- 3. Që të sqarojë qartë realitetin e ndikimit të NVM-ve në ekonominë e RMV-së*
- 4. Të mund të jap një pasqyrë të qartë rreth ndërmarrjeve që do ti marrim si raste studimi*

1.2 Hipotezat

Në funksion të lidhjes së lëndës dhe qëllimeve të hulumutimit në kuadër të këtij studimi, në këtë pjesë prezentohen 2 hipotezat bazë:

H1. Ekziston pamjaftueshmëri në sigurimin e burimeve të jashtme të financimit tek ndërmarrjet e NVM-ve.

H.2 NMV-të në rajonin e Pollogut kanë ndikimi të rëndësishëm në rritjen ekonomike PBB-GDP (përfshirë këtu tregtinë, exportin,importin)

1.3 Rëndësia e punimit

Ky hulumtim shkencor ka rëndësi të madhe në vendin dhe kushtet të cilat në jetojmë sot. Ndërmarrjet e vogëla dhe të mesme përbejnë shumicën dërrmuese të subjekteve afariste dhe kontribojnë fuqishëm në punësim dhe rritjen ekonomike por njëkohësisht përfshijnë edhe gjërësinë e plotë të industrive dhe sektorëve.

Saj përket vendit tonë Republikës së Maqedonisë së Veriut studimet rreth ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme janë të pakta. Pjesa më e madhe e studimeve janë fokusuar në arsyet pse NVM-të dështojnë në Rajonin e Tetovës.

Rëndësia e këtij punimi: jep një panoramë të plotë të të gjitha kostove direkte dhe indirekte të krijimit të ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme në Rajonin e Pollogut si dhe mënyrat e financimit të tyre.

KAPITULLI I 2

1. Hyrje

Lënda e këtij hulumtimi është ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të cilat kanë një rol shumë të rëndësishëm ekonomik dhe social në vendin tonë. Zhvillimi i NVM-ve ofron shumë mundësi punësimi, që mund të ndihmojnë në zvogëlimin e nivelit të papunësisë dhe në përballimin e sfidave demografike të këtyre popullatave, të cilat janë në rritje të shpejtë.

Është pranuar botërisht se ndërmarrjet e vogëla dhe të mesme janë aktiviteti kryesor ekonomik në vend. Lënda e hulumtimit në këtë punim masteri do të jetë pikërisht ndërmarrjet e vogëla dhe të mesme. Thënë ndryshe ata janë boshti i ekonomisë dhe duhet ti mbështetur në mënyrë që të zhvillohet ekonomia nëpërmjet këtyre baseneve.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë bizneset të cilat e përbëjnë 99 për qind të zhvillimit ekonomik dhe cilësohet si njëri ndër sektorët bazë në krijimin e një buxheti të qëndrueshëm ekonomik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë motori i zhvillimit ekonomik për shkak të vlerës së lartë të shtuar të produktit të brendshëm bruto.

Mjedisi i biznesit përcakton efikasitetin e sipërmarrjes: i vogël, i mesëm dhe i madh. Për këtë arsye të drejtat e përcaktuara mirë të pronës, puna efektive e institucionit, disponueshmëria e informacionit të gjitha rrisin efikasitetin e kompanisë.

Shumë NVM vuajnë mungesën e mbështetjes financiare. Kjo situatë përkeqësohet me paaftësinë e institucioneve dhe qeverisë për të drejtuar programe të mjaftueshme të ndihmës shtetërore. Institucionet lëshojnë lloje të ndryshme të dokumenteve, të cilat përbëhen nga plane dhe strategji zhvillimi, si përmirësohet dhe bëhet ekonomia e qëndrueshme dhe fitimprurëse.

Sipas mendimit tim integrimi global ekonomik si proces gjithnjë e më shumë po ka ndikim edhe në politikat nacionale të zhvillimit, ndaj si i tillë është jashtëzakonisht vështirë që të kontrollohet me aplikimin e metodave dhe instrumenteve tradicionale të zhvillimit ekonomik.

Kjo mbase vështirëson që në vitet në vijim, të planifikohen qëllime të caktuara ekonomike në nivel shteti. Të gjitha ndërmarrjet në botë, të mëdha apo të vogla, familjare dhe jo familjare, publike apo jo publike, të zhvilluara dhe të pa zhvilluara, po përballen me një sërë pyetjesh të cilat kanë të bëjnë me ardhmërinë dhe perspektivën e tyre, respektivisht vije në pikëpyetje ekzistenca e tyre në situata të paparapara turbulente për rrethinën.

Ndërmarrjet mikro dhe at makro kanë një peshë të madhë në ekonominë e një vendi. Kontributi që ato japin në rritjen, krijim e punësimit dhe zhvillimit social është për tu vlerësuar.

Zhvillimi ekonomik i një vendi varet prej shumë faktorësh. Njëri prej faktorëve të zhvillimit ekonomik të një vendi është edhe rritja e numrit të ndërmarrjeve të mëdha.

Ndërmarrjet e mëdha kanë avantazhe të shumta, në radhë të parë për vetë ndërmarrjen, pastaj edhe për ekonominë e përgjithshme të vendit. Këto ndërmarrje kanë likuiditet më të madh që mundëson kryerjen e detyrimeve që kanë ndaj palëve të treta, po ashtu forca financiare e ndërmarrjeve të mëdha mundëson kryerjen e kërkimeve të fizibilitetit.

Kjo rezulton me inicimin e projekteve të reja investuese, të cilat krijojnë vlere të reja për konsumatorët dhe si rrjedhojë, tërë kjo, ndikon edhe në zhvillimin ekonomik të vendit duke konkurruar edhe jashtë kufijve shtetërore. Këto me forcën që disponojnë janë në gjendje të kryejnë edhe “përgjegjësitë sociale” duke ulur nivelin e papunësisë dhe duke dhënë mbështetje në realizimin programeve të ndryshme sociale.

1. Rishikimi i literaturës

NVM-të janë treguesit kryesorë të zhvillimit ekonomik të një vendi. Ato kanë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin shoqëror të një vendi. NVM-të krijojnë vende pune, konkurrojnë me ndërmarrjet e mëdha, bëhen pjesë e tregut global, kontribuojnë në zbutjen e varfërisë në vendet në zhvillim, rritin eksportet dhe ulin importet.

Do të interpretohet lidhja rastësore midis NVM-ve dhe rritjes ekonomike. Rritja ekonomike përcaktohet nga Prodhimi i Brendshëm Bruto me çmime aktuale (PBB reale). Rezultati i arritur në mënyrë empirike, do të dëshmohet gjithashtu falë testeve të ndryshme diagnostikuese.

NVM-të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e zhvillimit ekonomik. Arrin në përfundimin se firmat e vogla janë motori i rritjes ekonomike globale. Në shumicën e vendeve, NVM-të dominojnë në infrastrukturën industriale dhe tregtare.

Ekonomistët besojnë se pasuria e kombeve varet nga performanca e NVM-ve të tyre. Në vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim, NVM-të kontribuojnë në stabilitetin e ekonomisë kombëtare.¹

Ato ndihmojnë ekonominë të përballojë tronditjet e cikleve ekonomike. NVM-të shërbejnë si motori kryesor për shpërndarjen e barabartë të të ardhurave midis punëtorëve.² Menaxherët e NVM-ve duhet të investojnë më pak në asete të prekshme, por më shumë në R&D.³

Nuk ka një përkufizim statik për NVM-të.⁴ Kjo sepse nuk ka kritere të njëtrajtshme për t'i matur në lidhje me sasinë e kapitalit, numrin e të punësuarve, qarkullimin, investimet në kapital fiks dhe makineri dhe pjesën e tregut.⁵ Këto ndryshime midis NVM-ve vërehen nga vendi në vend, nga industria në industri dhe nga autori te autorët.

¹ Jonathan E. Schroeder, Introduction to the special issue on aesthetics, images and vision, Volume 6(1): 5–10
Copyright © 2006 SAGE www.sagepublications.com DOI: 10.1177/1470593106061886

² Lee, H. & Choi, B. (2003). Knowledge management enablers, processes, and organizational performance: An integrative view and empirical examination. *Journal of Management Information Systems*, 20, 179-288.
<http://web.ebscohost.com.ezp.waldenulibrary.org>

³ Rousseau, DM, SB Sitkin, RS Burt and C Camerer (1998). Not so different after all: A cross-discipline view of trust. *Academy of Management Review*, 23, 393–404

⁴ Atkinson, R, L Crawford and S Ward (2006). Fundamental uncertainties in projects and the scope of project management. *International Journal of Project Management*, 24, 687–698.

⁵ Onwukwe, V. C. & Ifeanchi, M. I. (2011). Impact of government intervention on the growth of small and medium scale enterprises in Imo State. *International Journal of Research in Commerce, Economics & Management*, 1(7), 1-5, November

Këto janë përkufizime teorike dhe operacionale. Henriques, ⁶ në mënyrë specifike shprehet se përkufizimet teorike të NVM-ve marrin në konsideratë kriteret cilësore të tilla si autonomia, mirëkuptimi personal si dhe angazhimi financiar dhe personal i pronarit.

2. Qasja teorike dhe definimi i problemit

Sipas mendimit tim integrimi global ekonomik si proces gjithnjë e më shumë po ka ndikim edhe në politikat nacionale të zhvillimit, ndaj si i tillë është jashtëzakonisht vështirë që të kontrollohet me aplikimin e metodave dhe instrumenteve tradicionale të zhvillimit ekonomik.

Kjo mbase vështirëson që në vitet në vijim, të planifikohen qëllime të caktuara ekonomike në nivel shteti. Të gjitha ndërmarrjet në botë, të mëdha apo të vogla, familjare dhe jo familjare, publike apo jo publike, të zhvilluara dhe të pa zhvilluara, po përballen me një sërë pyetjesh të cilat kanë të bëjnë me ardhmërinë dhe perspektivën e tyre, respektivisht vije në pikëpyetje ekzistenca e tyre në situata të paparapara turbulente për rrethinën. ⁷

Ndërmarrjet mikro dhe at makro kanë një peshë të madhe në ekonominë e një vendi. Kontributi që ato japin në rritjen, krijim e punësimit dhe zhvillimit social është për tu vlerësuar. Zhvillimi ekonomik i një vendi varet prej shumë faktorësh. Njëri prej faktorëve të zhvillimit ekonomik të një vendi është edhe rritja e numrit të ndërmarrjeve të mëdha.

Ndërmarrjet e mëdha kanë avantazhe të shumta, në radhë të parë për vetë ndërmarrjen, pastaj edhe për ekonominë e përgjithshme të vendit. Këto ndërmarrje kanë likuiditet më të madhë që mundëson kryerjen e detyrimeve që kanë ndaj palëve të treta, po ashtu forca financiare e ndërmarrjeve të mëdha mundëson kryerjen e kërkimeve të fizibilitetit.

Kjo rezulton me inicimin e projekteve të reja investuese, të cilat krijojnë vlera të reja për konsumatorët dhe si rrjedhojë, tërë kjo, ndikon edhe në zhvillimin ekonomik të vendit duke konkurruar edhe jashtë kufijve shtetërore. Këto me forcën që disponojnë janë në gjendje të

⁶ Henriques, M. (1998). Business development services for SMEs: Preliminary guidelines for donor-funded interventions. Washington, World Bank.

⁷ Scully Gerald (1991): "Tax rates, tax revenues and economic growth", National Center for Policy Analysis, Policy Report no. 159

kryejnë edhe “përgjegjësitë sociale” duke ulur nivelin e papunësisë dhe duke dhënë mbështetje në realizimin programeve të ndryshme sociale.⁸

Po ashtu është dëshmuar se edhe ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme (NVM-të) kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, duke ulur nivelin e papunësisë, duke mundësuar ofrimin e produkteve të reja përmes strukturës fleksibile që kanë këto dhe një sërë avantazhesh tjera të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Për këtë Bashkimi Evropian (BE) është në proces të implementimit të shumë programeve për avancimin e tyre në shtetet e Evropës, pasi sipas tyre NVM-të shihen si faktorë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të BE-së. Madje BE-ja përmes projekteve të ndryshme u ofron mbështetje shteteve kandidate për avancimin e NVM-ve.

Integrimi i Maqedonisë në Strukturat e Unionit Evropian para se gjithash kërkon harmonizimin e sistemit ekonomik me vendet anëtare. Në kuadër të këtij sistemi ekonomik rol të veçantë luan reforma fiskale e sistemit tatimor.⁹ Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) janë të rëndësishme për kontributin e tyre në punësim, inovacion, rritje ekonomike dhe diversitet. Në mënyrë ideale, taksat duhet të jenë neutrale në lidhje me vendimet e biznesit të NVM-ve, duke përfshirë vendimet që lidhen me krijimin, formën dhe rritjen e tyre. Sistemi i taksave në ndërmarrjet e vogëla dhe të mesme është shumë i rëndësishëm duke pasur parasysh ekonominë vendase.¹⁰

Në botën janë gjithnjë e më tepër të pranishme marrëdhëniet e bashkëpunimit kooperativ ndërmjet ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha, të njohura si kooperacioni satelitor. “Sateliti” paraqesin ndërmarrje të vogla të cilat më së shpeshti i furnizojnë ndërmarrjet e mëdha me të mira, shërbime dhe materiale. “General Motors” p.sh. furnizohet dhe merr mall nga furnizues ku numri më i madh i tyre janë ndërmarrje të vogla, numri i të cilëve sillet mbi 30 000.

Arsyeja për gjithnjë e më të shpeshta marrëveshje kooperative ndërmjet bizneseve të vogla e të mëdha është fakti që ndërmarrjet e mëdha nuk mund të ofrojnë produkte aq të lira si bizneset e vogla. Nëpërmjet kooperimit, bizneset e mëdha i zvogëlojnë shpenzimet mesatare dhe

⁸ Musa, L., 2011. Zhvillimi i sektorit privat.[Intervistë].(Komunikim personal, Maj 2011).

⁹ Prof. Dr Rufi Osmani, Efektet e reformatave tatimore në performancën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në komunën e Tetovës dhe Gostivarit, Tetovë, 2009, fq.5

¹⁰ Rukiqi, B., 2011. Zhvillimi i sektorit privat.[Intervistë].(Komunikim personal, Maj 2011).

e zmadhojnë produktivitetin, a bizneset e vogla sigurojnë plasman të prodhimeve të tyre, me çka e zvogëlojnë rrezikun e falimentimit.

Biznesi i vogël dhe i mesëm janë një ndër karakteristikat më të rëndësishme në shoqërinë tonë dhe shoqëria jep mundësinë që këta biznese të krijojnë mundësi të reja punësimi dhe paraqiten si aktorë kryesore. Bizneset e vogëla të mesme janë si gjenerator kryesor dhe krijojnë mundësi të reja punësimi. Sipas të dhënave të shumë hulumtimeve 98% e gjithë aktivitetëve janë të drejtuar rreth biznesit. Biznesi i madh dhe i vogël edhe pse nuk punësojnë shumë persona, ata krijojnë mundësi të madhe për zhvillim ekonomik në një vend.

Një avantazh tjetër për bizneset e vogëla është se ata mund të marrim rrezikun e lëshimit të një produkti të ri, ata janë fleksibël dhe kanë hapsirë për manovrim në kushtet e ndryshimeve dhe përparimeve të shpeshta. Sektori i biznesit të vogël dhe të mesëm në secilin vend ndryshojnë çështjen në qeveri dhe përqendron edhe vëmendjen e tyre në zhvillimin ekonomik.¹¹ Pabarazia regjionale ekonomike dhe më shumë po rritet integrimi i ekonomive nacionale në tregun botërorë. Ferizaj si komunë ka filluar me shumë projekte për zhvillimin ekonomik, një gjë të tillë e ka realizuar duke hapur biznese të vogëla dhe të mesme.¹²

¹¹ Graham, Beaver, Small Business, Entrepreneurship & Enterprise Development, Edinburgh Gate, Harlow, Essex CM20 2JE, England, 2002, str.2

¹² Riinvest, vite të ndryshme. Zhvillimi i NVM-ve. Prishtinë: Instituti Riinvest.

3. Përkufizimi i NVM-ve

Ndërmarrjet e vogëla dhe të mesme përbejnë shumicën dërrmuese të subjekteve afariste dhe kontribojnë fuqishëm në punësim dhe rritjen ekonomike por njëkohësishtë përfshijnë edhe gjërësinë e plotë të industrive dhe sektorëve.¹³

Në të njëjtën kohë ndërmarrjet e vogëla dhe të mesme përballen me sfida të veçanta në lidhje me qasjen e tyre në financa. Sistemi tatimor luan një rol të dyfishtë: herën e parë si mjet për të ndihmuar në tejkalimin e sfidave herën tjetër si pengesë.

Statistikat tregojnë se pjesa më e madhe e bizneseve familjare kanë një jetëgjatësi që lë për të dëshiruar, 95% e bizneseve familjare nuk mbijetojnë në gjeneratën e tretë të pronësisë në një familje. Biznesi familjar përbën formën më mbizotëruese dhe më të vjetër të organizimit të biznesit, përfaqëson më shumë se 70% të biznesit në përgjithësi dhe luan rol vendimtar në zhvillimin ekonomik të një mjedisi.¹⁴

Në shtetet e BE-së NVM-të luajnë rol kyç në zhvillimin ekonomik për rolin e tyre si prodhues të vegjël që janë në shërbim të ndërmarrjeve të tjera prodhuese, pra këtu kemi të bëjmë me një rrjetëzim mes një ndërmarrjes prodhuese dhe shumë ndërmarrjeve të tjera të vogla ose të mesme të specializuara në fusha specifike që prodhojnë gjysmë produkti për ndërmarrjet më të mëdha me qëllim të plotësimit të nevojave të tyre për prodhimin e produkteve finale.¹⁵

Në një mënyrë, NVM-të në shtetet e BE-së janë mbështetës të ndërmarrjeve të mëdha që përmes këtij rrjetëzimi, tregut vendor dhe atij të jashtëm t'i ofrohen produkte konkurruese dhe në këtë mënyrë të krijohet stabiliteti dhe zhvillimi ekonomik.¹⁶

Mirëpo ndërmarrjet e BE-së për nga madhësia janë të balancuar në atë mënyrë që mund të krijohet bashkëpunim mes tyre dhe si rrjedhojë krijohen vlera për ekonominë e vendit. Në një mënyrë këto raporte tregojnë se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve të vendit tonë nuk kanë fuqi për të luajtur një rol më pozitiv për zhvillimin ekonomik të vendit për shkak të ndikimit të tyre të ulët. Për këtë, në RMV duhet të rritet numri i ndërmarrjeve të mëdha.

¹³ Prof.Asoc.Dr.Besnik Krasniqi, Prof. Dr. Enver Kutllovci, Prof.Asoc.Dr.Petrit Gashi, Prof.Dr. Muhamet Mustafa “ Biznesi i vogël dhe i mesëm” Krijimi, menaxhimi dhe rritja e bizneseve.

¹⁴ World Bank Group (2017). Western Balkans Regular Economic Report No.11

¹⁵ Riinvest, vite të ndryshme.Zhvillimi i NVM-ve. Prishtinë: Instituti Riinvest.

¹⁶ Prof.Asoc.Dr.Besnik Krasniqi, Prof. Dr. Enver Kutllovci, Prof.Asoc.Dr.Petrit Gashi, Prof.Dr. Muhamet Mustafa “ Biznesi i vogël dhe i mesëm” Krijimi, menaxhimi dhe rritja e bizneseve.

Sepse ndërmarrjet e mëdha kanë jetë më të gjatë, madje sipas një hulumtimi masa e mbylljes së ndërmarrjeve të vogla është më e madhe krahasuar me ndërmarrjet më të mëdha, ngase ndërmarrjet e mëdha janë më pak të luhatshme ndaj çdo lloj krize që mund të paraqitet, ndërsa ato të vogla (mikro ndërmarrjet) më shpejtë ndikohen dhe mund të përfundojnë me kapitullim.¹⁷

Për realizimin e strategjisë së zhvillimi të qeverisë fillimisht duhet të krijohen kushtet të përshtatshme për investime të huaja direkte. Përpara së të japim një përkufizim të NVM-ve le të shohim cilat janë karakteristikat tipike të tyre sipas disa studiuesve. *Janë shumë fleksibël – përparësia kryesore konkurruese e NVM-ve është fleksibiliteti i tyre; shpesh herë ato janë të afta të përmbushin shpejt kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve.*¹⁸

*Sjellin inovacion. Inovacioni përmes një programi të kërkimit dhe zhvillimi është jetik për ekzisencën e një NVM-je tipike.*¹⁹*Të shpejta në zbatimin e vendimeve të marra. Ato karakterizohen nga zbatimi i shpejtë i vendimeve të marra për të zbutur kërcnimet e jashtme dhe për të kapitalizuar mundësitë.*

¹⁷ Labeat Mustafa, Menaxhimi i ndërmarrjeve në kushtet e ekonomisë bashkëkohore (me vështrim të veçantë në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, Tiranë, dhjetor 2015)

¹⁸ Temperley, Galloway et al, 2004. Antony, Kumar et al 2005. Edwards, Delbridge et al 2005. Murphy dhe Ledwith 2007

¹⁹ Temperley, Galloway et al, 2004. Oke, Burke et al 2007, fq.22

4. Probleme të përkufizimit të NVM-vë

Nëse do të duam të japim një përkufizim se çfarë quajmë ndërmarrje të vogla e të mesme do të shohim se jo vetëm që është e vështirë por edhe që nuk ka pajtueshmëri në mendime të studiuesve, ekonomistë e politik bërësve. Sipas Story, vihet re një mungesë e cila është e njëtrajtshme në lidhje me përkufizimin.

Përkufizimi që përdorin përmasat nëse i përdorin në një sektor mund të ndodhë që të gjitha bizneset të klasifikohen në të vogla ndërsa të njëjta përmasa kur aplikohen në një sektor tjetër mund të çojnë në rezultatë të ndryshme.²⁰

Kjo pasi një biznes i vogël në sektorin e shërbimeve ka kapital, xhiro dhe punëson një numër të caktuar punjonësish të ndryshme nga ata që kanë një biznes. Kur diskutohet për çështjen e përkufizimit duhet edhe që ti referohemi edhe autorëve të tjerë për këtë lëmi të cilët janë përpjekur që të realizojnë përkufizim të biznesit të vogël, por nuk kanë pasur rezultate të kënaqshme.

Një nga arsyet që mund të arrihet një përfundim të kënaqshëm është problemi i përmasës.

Shteti	Kriteri i ndarjes	Mikro	Të vogla	Të mesme	Të mëdha
Australi	Nr.punjonësve	1-4	5-19	20-199	-200
Kinë	Nr. Punjonësve	E ndryshme sipas industrisë	<300	300-2000	>2000
BE	Nr. Punjonësve dhe xhiro vjetore	<10 <2 mil E	<50 <10 mil E	<250 <50 mil E	>250
OECD	Nr. Punjonësve	1-9	10-49	50-499	>500

Burimi: Temperley al,(Temperley, Galloway et al.2004), UN-ECE(1996), NBSC (2003)

Tabela 1.Shtetet në bazë të kriterit të ndarjes.

²⁰ Labeat Mustafa, Menaxhimi i ndërmarrjeve në kushtet e ekonomisë bashkëkohore (me vështrim të veçantë në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, Tiranë, dhjetor 2015

5. Roli dhe rëndësia e ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme në zhvillimin ekonomik

Ndërmarrjet e Vogla të Mesme (NVM) luajnë rol avital në zhvillimin ekonomik të shumë vendeve në botë, veçanërisht vendeve në zhvillim pasi ato kontribuojnë në aspektin e ekonomisë dhe punësimit.²¹

Studimi i NVM-ve kërkon një përkufizim të qartë, aktualisht nuk ka një përkufizim të pranuar në të gjithë botën për NVM-të.²² Duke e ditur se ndërmarrjet përballen me shumë sfida gjatë punës së tyre, jemi munduar që këtë temë ta shtjellomë më mjaftë përkushtim. Qëndrueshmëria ekonomike e një vendi mbështetet në nivelin e zhvillimit të bizneseve dhe ndikimin e tyre të përgjithshëm në faktorët mikro dhe makroekonomik.

Në këtë punim jemi munduar që të përkufizojmë menaxhimin dhe efikasitetin e bizneseve të vogla dhe të mesme, po ashtu kemi kuptuar rëndësinë dhe kontributin e NVM-ve në zhvillimin ekonomik. Pothuajse asnjë përkufizim nuk është i njëjtë me atë se çfarë i dallon bizneset e vogla nga ato të mëdha. Faktori kryesor në të cilin bazohen teoricienët dhe ekonomistët është numri i të punësuarve.²³

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) kanë një rol ekonomik dhe social shumë të rëndësishëm, për shkak të kontributin e tyre në funksionimin e rrjetit ekonomik dhe në krijimin e vendeve të punës. Këto kontribute janë shumë të vlershme në kushtet e krizës dhe të rritjes së papunësisë.

Sidomos në RMV, zhvillimi i NVM-ve mund të kontribuojë në përballimin e sfidave të shumta të lidhura me zhvillimin ekonomik, efektet e pabarazisë, nivelin e lartë të papunësisë, rritjen demografike dhe nevojën për ndryshime strukturale.

Duke u nisur nga fakti që ndërmarrësia si kulturë dhe koncept i të menduarit ekonomik, paraqitet si një resurs i rrallë, si agjent i ndryshimeve shoqërore (dhe politike). Krijimi i mjedisit për ide dhe iniciativa të reja, përkatësisht ndërtimi i sistemitë e stimulon dhe motivon njerëzit për të ndërmarrë diçka në lëmin e biznesit paraqet esencën e mardhënieve sociale kapitale të caktuara për zhvillimin e mentalitetit ndërmarrës. R

²¹ Mead, D. C., & Liedholm, C. (1998). The dynamics of micro and small enterprises in developing countries. *World Development*, 26(1), 61–74.

²² Beck, T. (2005). SMEs, growth, and poverty: cross-country evidence. *Journal of Economic Growth*, 10(3), 22

²³ Prof.Asoc.Dr.Besnik Krasniqi, Prof. Dr. Enver Kutllovci, Prof.Asoc.Dr.Petrit Gashi, Prof.Dr. Muhamet Mustafa “ Biznesi i vogël dhe i mesëm” Krijimi, menaxhimi dhe rritja e bizneseve.

MV-ja ka bazë të mirë për zhvillimin e sektorit privat. Korniza e ligjore dhe rregullative e saj është e bazuar në praktikat më të mira në sektorin privat që janë edhe stimuluese për zhvillimin e sektorit e privat. Euroja stabile është valutë e vendit.²⁴

Po ashtu ekzistojnë forca konkurruese në tregun e mallrave dhe shërbimeve. Sektori privat luan rol në rritje në çdo ekonomi kombëtare dhe kontribuon në punësim, të hyrat nga taksat, rritje ekonomike dhe kultivim të sistemit të tregut.

NVM-të përcaktohen ndryshe nga secili komb në varësi të fazës së zhvillimit ekonomik dhe mjedisit shoqëror.²⁵Standardet ndryshojnë nga një vend në tjetrin për shkak të potencialit të tyre të ndryshëm, aftësive, kushteve ekonomike dhe fazave të zhvillimit.

Projektet që janë të vogla ose të mesme në një vend të industrializuar mund të konsiderohen ndërmarrje në shkallë të gjerë në një vendi në zhvillim, vlerësimi i madhësisë së projektit mund të ndryshojë brenda vetë vendit, në varësi të fazave të rritjes në ekonominë e vendit dhe kushteve të tij ekonomike dhe sociale siç janë natyra e faktorëve të prodhimit, cilësia e artizanatit tradicional industritë para industrisë moderne, dendësia e popullsisë, disponueshmëria e fuqisë punëtore dhe niveli i rehabilitimit, të ardhurat dhe aspektet e tjera ekonomike dhe sociale që përcaktojnë karakteristikat dhe natyrën e industrive ekzistuese.²⁶

Përkufizimi gjithashtu ndryshon në varësi të qëllimit të tij, pavarësisht nëse është për qëllime statistikore ose për qëllime financimi ose për ndonjë qëllim tjetër. Rol të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit ka përshtatja e ndryshimeve strukturale, e mundësive dhe e kushteve të zhvillimit të bazuara në kërkesat e tregut për produktet dhe shërbimet e realizuara.

Zhvillimi i industrisë dhe resurset natyrore janë të një rëndësie të veçantë në këtë drejtim. Industria i kontribuon më së shumti zhvillimit ekonomik dhe ndarjes së punës.

Ajo krijon mundësi për rindërtimin dhe avancimin e degëve të tjera ekonomike si bujqësisë, komunikacionit, tregtisë e të tjera. Ndikimi i industrisë në transformimin e strukturës ekonomike dhe sociale të vendit është i lartë ose i dobët, varësisht nga niveli i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit.

²⁴ Prof.Asoc.Dr.Besnik Krasniqi, Prof. Dr. Enver Kutllovci, Prof.Asoc.Dr.Petrit Gashi, Prof.Dr. Muhamet Mustafa “ Biznesi i vogël dhe i mesëm” Krijimi, menaxhimi dhe rritja e bizneseve.

²⁵ Omar, S., Arokiasamy, L. & Ismail, M. (2009). The Background and Challenges Faced by the Small Medium Enterprises. A Human Resource Development Perspective. International Journal of Business and Management, (4) 10.

²⁶ Sllavica Kovačevska ,Velkova Zoran, Zlatkovski Dimitar Eftimovski, BAZAT E BIZNESIT, Shkup, 2010

6. Informacioni Background rreth ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme

Ndërmarrja e vogël ose e mesme (NVM), përkufizimi i së cilës ndryshon në vende të ndryshme dhe nivele të ndryshme të zhvillimit ekonomik, normalisht njihet si njësi relativisht e vogël e biznesit për sa i përket të punësuarve, kapitalit dhe shkallës së operacioneve krahasuar me ndërmarrjet e mëdha në të njëjtën industri.²⁷

Pavarësisht nga larmia e përkufizimit të saj, NVM-të luan një rol vendimtar pothuajse në çdo ekonomi, kontribuojnë jashtëzakonisht në zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe stabilitetin shoqëror.

Sipas Hauser²⁸ bëhet një vend i zakonshëm për të folur për NVM-të si një motor i rritjes ekonomike për çdo vend të Bashkimit Evropian. Në të vërtetë, thënia jo vetëm që është e kufizuar me vendet e Bashkimit Evropian, por gjithashtu funksionon në pothuajse çdo vend, të dhënat nga... tregojnë më shumë përmbajtje

Vështirësitë e financimit janë bërë një fjalë e zakonshme e NVM-ve. Qafa e shisheve të zhvillimit të NVM-ve lehtë mund të çojë në paqëndrueshmëri të strukturës kryesore të ekonomisë. Prandaj burimet e financimit për NVM-të dhe vështirësitë me të cilat ato përballen bëhet një shqetësim ndërkombëtar duke filluar nga ekonomitë në zhvillim dhe ato të zhvilluara që tërheq vëmendjen nga studiuesit dhe politikëbërësit në të gjithë globin, studime të shumta janë kryer në fusha kërkimore dhe një larmi politikash që mbështesin masat e financimit për NVM-të janë marrë në vende të ndryshme.

²⁷ Mr.sc.Vjollca Hasani-Limani, ROLI I MIKROFINANCIMIT DHE ZHVILLIMIT TË NMVM-VE NË ULJEN E VARFËRISË NË MAQEDONI, Tetovë, 2020

²⁸ Hauser. (2005). A qualitative definition of SME. OECD, Statistics Directorate. Bonn, Germany: OECD, Statistics Directorate.

7. Financimi i aktiviteteve afaristë të NVM-ve në Rajonin e Pollogut

Karakteristikat e financimit të NVM-ve, janë si pasojë e karakteristikave të vetë zhvillimit të ndërmarrjeve dhe ndërmarrësisë, si dhe të karakteristikave të sistemit financiar të vendit të caktuar se ku zhvillohet biznesi.²⁹

Varësisht nga natyra e çasjes në financa, trajtimi i financimit mund të bëhet nga ana e ofertës financiare, (potenciali financiar për kreditim i institucioneve financiare) apo kërkesës për mjete financiare, (kërkesa e bizneseve për mjete financiare), dallohen edhe sfidat dhe problemet e tyre.

Në ekonomi, dy lloje të burimeve të financim që mund të grupohet:

- Joformale dhe
- Burimet formale të financimit.³⁰

Në burimet informale të financimit të korporatave përfshin kursime të pronarëve të bizneseve, hua nga familja, miqtë si dhe para që vijnë nga kapitali jozyrtar i sipërmarrjes, të ashtuquajtur engjëj biznesi.

Grupi i burimeve zyrtare të financimit të ndërmarrjeve përfshin para nga institucionet financiare zyrtare siç janë bankat, dmth. Bankat komerciale, kapitalin sipërmarrës formal (join venture) dhe paratë që mobilizohen përmes bursës. Çdo biznes ka nevojë për burime njerëzore, logjistike dhe financiare. Burimet financiare mund të sigurohen në mënyra të ndryshme e me to pastaj sigurohen burimet tjera të nevojshme për operacionet e biznesit.³¹

Kursimet nga paga ose kursimet familjare janë forma më e shpeshtë për financimin e një biznesi familjar. Forma tjera të financimit të biznesit janë: huaja nga miqtë, bashkimi i kapitalit të disa pronarëve në formë ortakërie etj.³²

Këto forma të financimit të biznesit janë të zakonshme për biznese të vogla ku, përveç pronarit, në operacionet e biznesit angazhohen pak persona të cilët mund të kenë disa role në biznes. Pronari mundet njëkohësisht të jetë edhe drejtor ekzekutiv edhe menaxher financiar e eventualisht të përfshihet kohë pas kohe edhe si shitës për shkak se bizneset e vogla nuk kanë

²⁹ Ayyagari, M., & Demircuc-Kunt, A., & Maksimovic, V. (2011). "Small vs. Young Firms Across the World: Contribution to Employment, Job Creation, and Growth", Policy Research Working Paper Series 5631, The World Bank

³⁰ Vladimir Filipovski, "Financimi i bizneseve të vogla", në: Si të filloni biznesin tuaj, Qendra për Zhvillimin e Biznesit të Ri, Shkup, 2007, f. 205

³¹ RIINVEST, (2012). "Sektori bankar: Ndhimesë apo barierë", Prishtinë,

³² RIINVEST, (2012). "Sektori bankar: Ndhimesë apo barierë", Prishtinë,

volum të madh të transaksioneve. Kredia si formë e financimit të biznesit është me e zakonshme për bizneset e mesme dhe të mëdhatë, kryesisht të regjistruara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.) ose si shoqëri aksionare (SH.A).³³

Ky lloj biznesi harton pasqyrat financiare të cilat ia prezanton bankës kur aplikon për kredi. Pasqyrat financiare i shërbejnë bankës për të vlerësuar pozitën financiare të biznesit, gjegjësisht aftësinë e biznesit për të kthyer kredinë e marrë. Me një fjalë, pasqyrat financiare tregojnë se sa është i shëndetshëm biznesi dhe sa janë gjasat që ai biznes të vazhdojë të ekzistojë dhe të operojë me sukses. Nëse banka e vlerëson se biznesi është i shëndetshëm ajo ia aprovon kërkesën për kredi, përndryshe e refuzon atë.³⁴

Zakonisht bizneset e reja (start-up) e kanë më të vështirë të marrin kredi për shkak se në mungesë të përvojës së biznesit banka duhet të bazojë vlerësimin e saj në një plan biznesi. Kjo përbën një rrezik më të madh dhe e bën kredinë edhe më të shtrenjtë (sa më i madh rreziku aq më shumë fitim kërkon banka). Për këto lloj biznesesh dhe për bizneset e vogla individuale kredi ofrojnë institucionet mikro-financiare por me norma më të larta të kamatës.³⁵

Formë tjetër i financimit të biznesit, që aktualisht mungon në RMV është bursa e aksioneve. Ajo është vend ku tregtohet me aksionet e bizneseve të ndryshme (SH.P.K. dhe SH.A), gjegjësisht transferohet një pjesë e pronësisë nga një pronar tek pronari tjetër i ri.

Ka biznese të suksesshme që duan të zgjerohen por ju mungon kapitali. Në anën tjetër ka subjekte që kanë tepriçë të parave të cilat nuk deponohen në banka për shkak se norma e kamatës për depozita është tepër e ulët – 1 % vjetore (rreth 0,08% mujore) – prandaj mbesin si para të paangazhuara.³⁶

Përmes bursës së aksioneve bizneset mund të zgjerojnë operacionet e tyre duke emetuar (shitur) aksione të reja ndërsa investuesit mund të investojnë paratë e tepërta të tyre duke ua blerë aksionet. Investuesit mund të arrijnë kthim më të lartë në investimin e tyre ndërsa kompanitë përveç që e zgjerojnë biznesin mund të menaxhojnë më mirë rrezikun nga humbja duke e transferuar atë tek investuesit.

³³ Tmava, Q. (2014) "Roli i Bankave në Menaxhimin e Investimeve në NVM-të në Kosovë" Dorëshkrim doktrate në UP

³⁴ Vladimir Filipovski, "Financimi i bizneseve të vogla", në: Si të filloni biznesin tuaj, Qendra për Zhvillimin e Biznesit të Ri, Shkup, 2007, f. 205

³⁵ Tmava, Q. (2014) "Roli i Bankave në Menaxhimin e Investimeve në NVM-të në Kosovë" Dorëshkrim doktrate në UP

³⁶ Tmava, Q. (2014) "Roli i Bankave në Menaxhimin e Investimeve në NVM-të në Kosovë" Dorëshkrim doktrate në UP

Por në mungesë të bursës së aksioneve dalin të dy humbës, në njërin anë pronari i parave të paangazhuara dhe në anën tjetër biznesi i suksesshëm i cili ka mundësi të zgjerojë biznesin por nuk mund ta financojë atë.³⁷

Norma e kamatës prej 0,55% mujore nuk e bën kredinë formë atraktive të financimit. Edhe po të jetë norma e kamatës e ulët prapë kredia nuk është formë atraktive e financimit të biznesit sepse banka nuk e ndan rrezikun e investimit me biznesin.³⁸

Megjithatë, në mungesë të bursës së aksioneve, bizneset detyrohen t'iu drejtohen bankave, edhe pse kredia nuk është alternativa më e mirë e financimit as për bizneset e reja as për ato ekzistuese qoftë për shkak të normës së lartë të kamatës qoftë për shkak se banka mund të mos ua financojë biznesin fare.

³⁷ Tmava, Q. (2014) "Roli i Bankave në Menaxhimin e Investimeve në NVM-të në Kosovë" Dorëshkrim doktrate në UP

³⁸ Tmava, Q. (2014) "Roli i Bankave në Menaxhimin e Investimeve në NVM-të në Kosovë" Dorëshkrim doktrate në UP

KAPITULLI I 3

1. FINANCIMI I NVM-VE NË RAJONIN E POLLOGUT

Secila ndërmarrje ne Pollog vazhdimisht ka nevojë të shfrytëzon mjete financiare. Kjo do të thotë se në ndërmarrje realizohet proces i vazhdueshëm i financimit, i cili ndryshohet varësisht nga ndryshimi i kushteve të shfrytëzimit të kapitalit të disponueshëm.³⁹

Financimi paraqet përpjekje për të siguruar mjete të mjaftueshme fi nanciare, të nevojshme për rrjedhje normale të punës dhe zhvillimit të biznesit. Ose thënë me fjalë tjera, nën financim nënkuptohet përpjekja e pronarit të ndërmarrjes për sigurim dhe shfrytëzim të drejtë të mjeteve financiare personale dhe të huaja, të nevojshme për realizimin e qëllimeve të vendosura.

Në definicionin për financim janë të përfshirë këto segmente kyçe: I pari, pronari i biznesit në fillim ndërmerr varg aktivitetesh për gjetje të mjeteve financiare për fillim të biznesit.⁴⁰

Segmenti i dytë i dedikohet mënyrës së drejtë të shfrytëzimit të mjeteve fi nanciare, për shkak të arritjes së përfitimit ekonomik, dhe segmenti i tretë i dedikohet mënyrës dhe dinamikës së kthimit të mjeteve fi nanciare, nëse ndërmarrja, përveç mjeteve financiare personale, shfrytëzon edhe të huaja. Financimi nga burimet personale bazohet në mjetet e pronarëve të ndërmarrjeve, për të cilat nuk ekziston obligimi i kthimit. Burimet personale të mjeteve fi nanciare shpesh para qesin burime themelore nga të cilat sigurohet puna e ndërmarrjes.⁴¹

Themeluesit e ndërmarrjes (qofshin ato një ose më tepër persona fizik ose juridik), nëpërmjet depozitave të tyre, e sigurojnë volumin e mjeteve të nevojshme për fillim të biznesit. Edhe përkundër përparësisë së madhe që e ka financimi nga mjetet personale, praktika tregon se thuajse i pashmangshëm është edhe shfrytëzimi i mjeteve nga burime të huaja.⁴²

Burimet personale të mjeteve financiare shpesh herë nuk mjaftojnë për investim fillestar ose për investim në zgjerimin e punës së ndërmarrjes. Burime të huaja më të shpeshta të financimit të punës së ndërmarrjes janë: bankat, ndërmarrjet partnere, fondet investuese, kompanitë e sigurimeve, kursimoret, etj.⁴³

³⁹ Sllavica Kovačevska Vellkova Zoran Zlatkovski BIZNESI, Shkup, 2010, fq.106

⁴⁰ Stigitz, J.E. and Weiss, A.(1981). “Credit Rationing in Markets with Imperfect Information”, American Economic Review, 71: 393-410

⁴¹ RIINVEST, (2012). ”Sektori bankar: Ndhimesë apo barierë”, Prishtinë,

⁴² RIINVEST, (2012). ”Sektori bankar: Ndhimesë apo barierë”, Prishtinë,

⁴³ UNCTAD, (2001). ”Survey of Good Practice in Public- Private Sector Dialogue”, Enterprise Development Series, New York, and Geneva: United Nation

Ato ndërmarrjeve mund tu aprovojnë kredi afatshkurtra dhe afatgjata. Përveç këtyre, ndërmarrjet shfrytëzojnë edhe burime tjera të financimit, siç është mbledhja e mjeteve financiare nëpërmjet emisioneve të aksioneve dhe biletave me vlerë korporative.⁴⁴

2. Financimi i NVM-ve në vendet e zhvilluara dhe në vendet e rajonit

Financat janë identifikuar në shumë sondazhe të biznesit si faktori më i rëndësishëm që përcakton mbijetesën dhe rritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si në vendet në zhvillim ashtu edhe në vendet e zhvilluara. Aksesit në financa lejon që NVM-të të ndërmarrin produktivitet investime për të zgjeruar bizneset e tyre dhe për të marrë teknologjitë më të fundit, duke siguruar kështu konkurrencën e tyre dhe të kombit në tërësi.⁴⁵

Sistemet financiare me funksionim të dobët mund të minojnë seriozisht bazat mikroekonomike të një vendi, duke rezultuar në rritje më të ulët të të ardhurave dhe punësimit.

Çasja në financa dhe menaxhimi i tyre, është përcaktori kyç për fillim të biznesit, rritje dhe zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve).⁴⁶

Përkundër faktit se NVM-të në vendet e zhvilluara kanë mundësi më të lehtë të çasjes në burimet e jashtme të financimit të nevojave biznesore, prap se prap ndër problemet madhore më të cilat ndeshen NVM-të është edhe problemi i çasjes në financa. Kështu, në pyetsorin e Komisionit Europian, të implementuar nga BQE (Banka Qendrore Europiane, 2012) në mënyrë permanente konfirmohet se në problemet kyçe në të cilat hasë biznesi gjatë zhvillimit të saj është edhe casja në financa.

Çështje kruciale në rritjen dhe zhvillimin e NVM-ve, është mundësia e çasjes në financa përmes burimeve të jashtme të financimit, pasi që burimet e brendshme nuk janë të mjaftueshme për një rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Aq më tepër kur trajtohet çështja e rritjes dhe zhvillimit të ndërmarrjeve në vendet të cilat kanë pasur ose ende ndeshen me problemet e transformimit të pronës, privatizimit, ekonomisë joformale, mungesës së eksperiencës në menaxhim të biznesit të vogël, siç është rasti me shumicën e vendeve të EJT, ku tregon edhe vendi ynë.

⁴⁴ Silavica Kovačevska Vellkova Zoran Zlatkovski BIZNESI, Shkup, 2010, fq.106

⁴⁵ UNCTAD, (2001). "Survey of Good Practice in Public- Private Sector Dialogue", Enterprise Development Series, New York, and Geneva: United Nation

⁴⁶ Falcetti, E., Sanfey and Taci. A, (2003). "Bridging the gaps. Private sector development, capital Flows, and the Investment Climate in South Eastern Europe", Working Paper, No 80, EBRD

(Vendet të cilat përfshihet në kuadër të EJT janë: Shqipëria, BeH, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Serbia, si dhe Bullgaria dhe Rumunia të cilat tashmë janë pjesë e EU-së).

Andaj, pa burime të jashtme financiare NVM-të kanë mundësi të kufizuara për zgjerimin e aktiviteteve biznesore, rritjen e kapaciteteve prodhuese ose furnizimin me paisje të reja. Hulumtimet e bëra lidhur me financimin e aktiviteteve ndërmarrëse në vendet e EJT-së, rezultojnë se qasja në financa është problemi madhor.⁴⁷

Në mesatare, "47% e kompanive të EJT-së, konsiderojnë se vështirësi kryesore në rritje dhe zhvillim të tyre është qasja në financa. Posaçërisht, NVM-të janë më të goditura. Për shkak se fondet të cilat atyre u nevojiten janë përtej kapaciteteve të huadhënësve joformal (psh familja, miqtë) NVM-të, në përgjithësi, sigurojnë financimin përmes bankave"përkundër vështirëve të mëdha në qasje në financa, që llogariten: problemet e sigurimit të të dhënave të besueshme, asimetrisë së informacionit, mungesës së kolateralit të nevojshëm etj.⁴⁸

Karakteristikë kryesore e ambientit financiar të kompanive në vendet e EJT-së, është dominimi i institucioneve bankare. Në çdo ekonomi të vendeve të EJT, për të gjitha llojet e firmave, financimi përmes bankës është ranguar si forma më e shfrytëzuar e burimeve të jashtme të financimit.

3. Veçoritë e financimit të NVM-vë në Rajonin e Pollogut

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) kanë një rol ekonomik dhe social shumë të rëndësishëm, për shkak të kontributit të tyre në funksionimin e rrjetit ekonomik dhe në krijimin e vendeve të punës. Këto kontribute janë shumë të vlershme në kushtet e krizës dhe të rritjes së papunësisë.⁴⁹

Sidomos në RMV, zhvillimi i NVM-ve mund të kontribuojë në përballimin e sfidave të shumta të lidhura me zhvillimin ekonomik, efektet e pabarazisë, nivelin e lartë të papunësisë, rritjen demografike dhe nevojën për ndryshime strukturale.

⁴⁷ BQK (2011). "Raporti vjetor", Prishtine, Banka Qendrore e Kosoves

⁴⁸ Beck, T., Demirguc-Kunt, A., Laeven, L., and Maksimovic, V.(2006). "The Determinants of Financing Obstacles", Journal of International Money and Finance, 25 (6): 932-952

⁴⁹ Mustafa, Isak. Ndërmarrja në biznesin bashkëkohor, Biblioteka Perspektiva në biznes, Prishtinë, 1997, fq.22

Zhvillimi i NVM-ve ofron shumë mundësi punësimi, që mund të ndihmojnë në zvogëlimin e nivelit të papunësisë dhe në përballimin e sfidave demografike të këtyre popullatave, të cilat janë në rritje të shpejtë. Përveç kësaj, zhvillimi i sektorit të NVM-ve mund të kontribuojë në përforcimin e konkurrueshmërisë dhe të prodhueshmërisë, duke nxitur njëkohësisht rritjen e të ardhurave globale dhe të ardhurave për frymë. Ky zhvillim do të promovojë edhe transformimin struktural të sektorit të NVM, për shkak të lidhjes së tij me inovimin dhe zhvillimin teknologjik.

50

Nga ana tjetër, ky proces kontribuon në zhvillimin rajonal dhe lokal, si edhe në kohezionin social, duke mundësuar zvogëlimin e pabarazive, sepse rritja e të ardhurave të një segmenti të gjerë të popullsisë do të përforcojë kërkesat për një qeverisje më të mirë. Këto zhvillime pozitive do të përmirësojnë mundësitë ekonomike dhe politike, duke transformuar projektimet demografike dekurajuese, të cilat thellojnë varfërinë dhe paqëndrueshmërinë, në forca që mund të shkaktjnë ndryshime positive.⁵¹

⁵⁰ Prof.Asoc.Dr.Besnik Krasniqi, Prof. Dr. Enver Kutllovci, Prof.Asoc.Dr.Petrit Gashi, Prof.Dr. Muhamet Mustafa “ Biznesi i vogël dhe i mesëm” Krijimi, menaxhimi dhe rritja e bizneseve.

⁵¹ Prof.Asoc.Dr.Besnik Krasniqi, Prof. Dr. Enver Kutllovci, Prof.Asoc.Dr.Petrit Gashi, Prof.Dr. Muhamet Mustafa “ Biznesi i vogël dhe i mesëm” Krijimi, menaxhimi dhe rritja e bizneseve.

KAPITULLI I 4

1. BURIMET E FINANCIMIT TË NVM-VË NË RAJONIN E POLLOGUT

Çdo ndërmarrje vazhdimisht ka nevojë të shfrytëzojë mjete financiare. Kjo do të thotë se në ndërmarrjen realizohet proces i vazhdueshëm i financimit i cili ndryshon varësisht nga ndryshimi i kushteve të shfrytëzimit të kapitalit të disponueshëm.

Financimi është këmbëngulje për të siguruar mjete të mjaftueshme financiare, të domosdoshme për rrjedhjen normale të punës dhe zhvillimit të biznesit. Apo thënë me fjalë tjera, me financim nënkuptohet përpjekje e pronarit të ndërmarrjes për sigurimin dhe përdorimin e drejtë të mjeteve financiare personale dhe të huaja, të domosdoshme për realizimin e qëllimeve të parapara.⁵²

Ekzistojnë kritere të ndryshme sipas të cilave bëhet klasifikimi i burimeve dhe mënyrave të financimit të biznesit, por në të shumtën e rasteve ato ndahen në burime personale dhe të huaja të financimit.⁵³

Financimi nga burimet personale bazohet në mjetet e pronarëve të ndërmarrjeve për të cilat nuk ekziston obligim për kthimin e tyre. Burimet personale të mjeteve financiare paraqesin burime themelore prej të cilave sigurohet puna e ndërmarrjes.

Ekzistojnë më shumë lloje të burimeve personale të financimit të cilat mund të ndahen në dy grupe edhe atë:

a) Mjete në formë të investimeve të pronarëve gjatë themelimit të ndërmarrjes: Kapitali i pronarit të ndërmarrjes është burimi themelor i financimit të biznesit.⁵⁴

Që të fitohet një biznes nevojitet të sigurohen mjete financiare (shuma minimale është përcaktuar me Ligj) në atë sasi dhe strukturë i cili do t'i përgjigjej veprimtarisë dhe madhësisë së ndërmarrjes. Mjetet financiare të pronarit mund të rrjedhin prej shumë burimeve: kursimeve, parave nga shitja e pronës së patundur personale, para nga shitja e letrave personale me vlerë, trashëgimia, dhurata etj.

⁵² Bucholz, G. Todd (2000), "Ide të gjalla nga ekonomistë të vdekur", ISP & DITA, Tiranë f. 302 - 303

⁵³ Sllavica Kovačevska Velkova Zoran Zlatkovski, BIZNESI, Shkup, 2010, fq.112

⁵⁴ Po aty

Ndërmarrjet të cilat janë themeluar prej më shumë themeluesve (siç janë: Shoqata me përgjegjësi të kufizuar, Shoqëritë tregtare publike dhe etj) fillojnë me punë, duke i përdorur investimet e themeluesve. Ky kapital formohet në bazë të marrëveshjes mes investitorëve, themelues të ndërmarrjeve.⁵⁵

Me marrëveshjen përcaktohet vlera e investimeve që duhet secili prej themeluesve ta investojë. Investimi i secilit partner vihen në funksion të realizimit të veprimtarisë së ndërmarrjes, ndërsa efektet e punës u takojnë të gjithë partnerëve varësisht nga mjetet e investuara.

Mjetet nga kursimet që krijohen në punën e ndërmarrjes. Në këto mjete numërohen: Fitimi (profiti) është burimi më i rëndësishëm i financimit të ndërmarrjes. Mundësia për ta financuar punën personale është shumë e madhe, nëse ndërmarrja realizon fitim.⁵⁶

Amortizimi është njëra nga mënyrat përmes të cilave pronari i ndërmarrjes mund të financojë një pjesë të punës. Amortizimi paraqet shprehje financiare të shpenzimit të kapitalit fiks. Amortizimi si formë e financimit vjen në shprehje tek ato biznese ku mjetet e vazhdueshme fikse kanë vlerë të lartë dhe e ndjejnë presionin e zhvillimit tekniko-teknologjik.

Ky burim ndonëse nuk e rrit kapitalin e ndërmarrjes, megjithatë paraqet shumë të rëndësishme të mjeteve financiare për shkak të faktit se kompenson vlerën e shpenzuar të mjeteve të vazhdueshme (fikse). Nëse burimet personale të mjeteve nuk janë të mjaftueshme, atëherë biznesi detyrohet të shfrytëzojë burime (të huaja) shtesë të mjeteve që i siguron në tregun financiar.

2. Sistemi tatimor në funksion të zhvillimit ekonomik të NVM-vë në Rajonin e Pollogut

Në fillim të viteve 90, me futjen e një sistemi të ri ekonomik në vend, ne kemi prezantuar një sistem të ri tatimor të bazuar në parimet e ekonomisë së tregut, pronës private, autonominë e subjekteve ekonomike . Parimi i ri është ngulitur në sistemin fiskal aktuale i Maqedonisë është parimi i neutralitetit alokimit të taksave dhe buxhetit, sipas të cilit instrumentet e politikës fiskale do të inkurajohen dhe mbështeten disa sektorë.⁵⁷

⁵⁵ A. Hoxhiç „Fleksibilizimi i procesit të punës”, Instituti për hulumtime shoqërore, Zagreb v.2005

⁵⁶ Sllavica Kovačevska Velkova Zoran Zlatkovski, BIZNESI, Shkup, 2010, fq.112

⁵⁷ Grup i autorëve - “Ndërmarrjet e vogla në zhvillimin e R. Maqedonisë “; Instituti Ekonomik; Shkup v.2002

Parimi i ri i rëndësishëm është heqja e kontributeve dhe zëvendësimin e tyre me taksat. Rezervuar vetëm kontributet në fondet sociale ose të kontributeve për shëndetin, sigurimin pensional dhe invalidor. Ajo afirmon parimin e zhvendosur barrën e taksave nga të drejtpërdrejtë për tatimet indirekte, që do të thotë reduktuar pjesën e tatimeve mbi të ardhurat duke rritur taksat mbi konsumin.⁵⁸

Në vitin 1994 fillon reformën e parë të sistemit tatimor të Republikës së Maqedonisë me Ligjin e ri për Tatimin në të Ardhurat Personale (TAP) , Ligji për tatimin mbi fitimin (GDL), Ligjin për tatimet e pronës, dhe kur fillon të operojë Zyrën e të Hyrave Publike (PRO) si institucion përgjegjës për identifikimin, mbledhjen dhe kontrollin e taksave në vend për të gjithë tatimpaguesit. Akt themelimin Zyrën e të Hyrave Publike në Republikën e Maqedonisë është Ligji për Drejtorinë e të Ardhurave Publike ("Gazeta Zyrtare" nr 80 e 30.12.1993, dhe në fuqi nga 01.01.1994 vit).

Miratimi i këtij ligji Administrata Kombëtare të ardhurave dhe organet e saj rajonale ekzistuese - departamentet e taksimit dhe departamentet e inspektimit, të vazhdojë të punojë si e Hyrë me qëllimin e ri të përcaktuara me këtë ligj. Institucioni i ri merr dhe përfshin në strukturën e tij dhe stafin e Departamentit të Kontabilitetit të Republikës së Maqedonisë duke punuar në kontrollin. Në një reformë të madhe të sistemit të taksave të Maqedonisë është konsideruar futjen e TVSH- së më 1 prill 2000 (TVSH zëvendëson taksën e shitjes të mëparshme mbi produktet dhe shërbimet) dhe sistemin e ri të taksimit të mallrave që i nënshtrohen akcizës, në vitin 2001.

Ligji i të Hyrave Publike miratuar në shtator të vitit 2005, me ndryshimet që pasuan më pas, kuadri i tanishëm ligjor që rregullon fushëveprimin, organizimin, mënyrën e veprimeve që kryejnë dhe të menaxhimit, si dhe kompetencave dhe përgjegjësi në mbledhjen, regjistrimin, përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave që lidhen me PRO. ⁵⁹

Miratimi i ligjit procedural të taksave në vitin 2006, që rregullojnë të drejtën e përgjithshme tatimore dhe procedurat administrative tatimore, vlerësimin tatimor, procedura e kontrollit, procedura e mbledhjes së të hyrave publike, të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesve, procedurat e ankesës, sjelljen e procedurave dhe dispozitat për kundërvajtje ligjore.⁶⁰

⁵⁸ Grup i autorëve - “Ndërmarrjet e vogla në zhvillimin e R. Maqedonisë “; Instituti Ekonomik; Shkup v.2002

⁵⁹ Grup i autorëve - “Ndërmarrjet e vogla në zhvillimin e R. Maqedonisë “; Instituti Ekonomik; Shkup v.2002

⁶⁰ <http://www.ujp.gov.mk/m/vodic>

3. Ndikimi i NVM-vë në rritjen ekonomike

Në botën e sotme, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) kanë kontribuar jashtëzakonisht drejt mirëqenies sociale dhe ekonomike të vendeve. Afrika nuk mbetet aspak prapa dhe për këtë arsye NVM-të po bëhen një forcë kryesore për të nxitur ekonominë e vendeve në zhvillim.

NVM-të janë njohur si një mjet i rëndësishëm në rritjen ekonomike të çdo kombi duke kontribuar drejt produktit të brendshëm bruto (PBB), duke krijuar vende pune, ulje të varfërisë, gjenerojnë të ardhura dhe lehtësojnë pasurinë e kombit duke rezultuar kështu në zhvillimin kombëtar.⁶¹

Në përgjithësi, zhvillimi ekonomik i një kombi mund të matet në terma të produktit të brendshëm bruto (PBB), të ardhurave kombëtare bruto (GNI), normës së inflacionit, shkallës së punësimit dhe treguesve të tjerë të nevojshëm. Zhvillimet në fushën e rritjes ekonomike janë të bazuara në teorinë neoklasiste të Robert Solow si dhe Paul Romer.⁶²

Teoria neoklasiste e rritjes bazohet në premisën se rritja e një vendi (rritje e GDP-së reale) është rezultat i avancimeve në teknologji, e cila shkakton një nivel të kursimeve dhe të investimeve, të cilat rrisin kapitalin për orë të punës që si rrjedhojë ka rritjen ekonomike të një vendi.

Dallimi në mes të Solow-it dhe Romer-it qëndron në faktin se i pari konsideron avancimet në teknologji si pasojë e forcave jashtë sistemit, ndërsa Romer insiston se ‘rritja ekonomike është rezultat i forcave brenda sistemit ekonomik’ e jo të ndonjë force jashtë tij. Ky i fundit gjithashtu beson se rritja ekonomike nuk është vetëm rezultat i faktorëve tradicional të prodhimit (kapitalit dhe punës, dy faktorëve kyq mbi të cilët bazohet teoria e Solow-it) mirëpo është edhe rezultat i dijes e cila gjenerohet përbrenda sistemit.⁶³

Një risi e madhe të cilën e sjell Romer-i është edhe se dija është e mire publike, kjo do të thotë se asnjë individ nuk mund të privohet nga shfrytëzimi i saj. Edhe pse rëndësia e bizneseve të vogla për rritjen ekonomike të shteteve u bë e evidente gjatë viteve shtatëdhjeta, deri në të tetëdhjetat e vonshme askush nga teoricientet nuk merrej me këtë kategori të bizneseve.⁶⁴

⁶¹ D. Pa M. Z. Potevska - “Perspektivat e biznesit të vogël”, Shkup v.2000 ndev - “Udhëheqës për ndërmarrësi dhe biznes të vogël”; Instituti Ekonomik; Shkup v.2000

⁶² M. Z. Potevska - “Perspektivat e biznesit të vogël”, Shkup v.2000

⁶³ T. Fiti dhe V. H. Markovska “Ndërmarrësi dhe menaxhmenti i sipërmarrjes Fakulteti ekonomik- Shkup v.1994

⁶⁴ S. Spasov - “Menaxhmetni i prodhimit”, Fakulteti ekonomik v.2002

Tani është e qartë se këto biznese kontribuojnë në masë të madhe në zhvillimin ekonomik të një vendi. Rritja e numrit të bizneseve të vogla brenda një industrie ndikon në zhvillimin ekonomik përmes dy kanaleve:⁶⁵

1. Rritjes së konkurrencës e cila përmirëson performancën ekonomike dhe
2. Rritjes së përqindjes së bizneseve të vogla në treg shton nevojën për inovacione të produkteve dhe shërbimeve si dhe avancime të tjera në teknologjinë nga ana e vetë bizneseve të vogla sepse duhet inovuar po që se dëshirohet të sigurohet konkurrenca në treg.

Autorë të tjerë si Audretsch dhe Thurik bëjnë ndërlidhjen në mes të vetëpunësimit dhe krijimit të vendeve të reja të punës që sigurohen nga bizneset e vogla si dhe efektet të tërthorta të krijimit të vendeve të punës në zhvillimin ekonomik.

Për më tepër, konsiderohet se për ekonominë nacionale është tejet e rëndësishme ta kenë një raport optimal të bizneseve të vogla dhe të mëdha. Ekonomia të cilat kanë një përqindje më të madhe të bizneseve të vogla dalin më lehtë dhe me më pak pasoja nga recesioni.

Shumë studiues Carree, Van Stel, Thurik, Audretsch besojnë se është mjaftë i rëndësishëm ky optimum në mes të këtyre dy kategorive sepse prezenca më e madhe e njërës nga këto kategori në strukturën industriale të një ekonomie mund të ndikoj negativisht në rritjen ekonomike. Sipas Audretsch dhe Thurik ky optimum është specifik për vende të caktuara, sepse secila ekonomi ka një numër karakteristikash specifike të cilat e influencojnë këtë optimum.⁶⁶

Këto specifika mund të jenë të natyrës institucionale, politika të aplikuara ekonomike, histori të cilat kanë ndikim në distribuimin specifik të ndërmarrësisë nëpër këto vende. Prezenca më e madhe se optimalja e bizneseve të vogla do të ndikonte në orientimin e biznesit në tregun vendor, zvogëlim të kërkesës për kapital dhe shërbime për konsulencë, mos-shfrytëzim të tregjeve në të cilat mund të përfitohet nga prezenca e ekonomisë së shkallës.⁶⁷

Në anën tjetër, numri mbi optimumin i bizneseve të mëdha do ta bënte ekonominë rigjide sepse bizneset e vogla janë burimi kryesor i ndryshimeve në ekonomi. Kjo do të rriste tendencat për aktivitete monopoliste dhe oligopoliste në ekonominë nga të cilat do të pesonin konsumatorët.⁶⁸

⁶⁵ S. Spasov - "Menaxhmetni i prodhimit", Fakulteti ekonomik v.2002

⁶⁶ S. K. Velskovska, Z. Zlatkovski - "Hyrje në biznes"; Prosvetno delo, Shkup v.2006

⁶⁷ Grup i autorëve - "Ndërmarrjet e vogla në zhvillimin e R. Maqedonisë"; Instituti Ekonomik; Shkup v.2002

⁶⁸ Justina Pula-Shiroka, Prishtinë 2013 - 'Sfidat dhe prespektivat e NVM-ve në Kosovë' fq.25-33

Përkundër faktit se, shumica e firmave në vendet në zhvillim janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM) dhe janë njohur si aktorët kryesorë në zhvillimin ekonomik; është e vështirë të merren prova specifike të kontributeve të bëra nga NVM-të.

Kjo sepse, NVM-të veprojnë pothuajse në të gjithë sektorët, mishërojnë madhësi të ndryshme të firmës; ndryshojnë për sa i përket nivelit të formalitetit dhe njohurive teknologjike. Ritmet e rritjes ekonomike u ngadalësuan në 2.4 % në vitin 2016 pasi pasiguria politike shkaktoi një rënie të investimeve private. Rritja ekonomike në 2017-19 parashikohet të jetë mesatarisht 3.3 %, nëse shuhen pasiguritë politike dhe rivendoset besimi.

Stimuli i konsiderueshëm fiskal dhe tkurrja e forces së punës quan në reduktimin e papunësisë. Mos-realizimi i shpenzimeve kapitale ngushtoi deficitin fiskal në vitin 2016, edhe pse shpezimet korrente vazhduan të rriten. Borxhi publik dhe publikisht i garantuar arriti në 48 % të PBB-së.⁶⁹ Stimulimi i besimit dhe rritjes ekonomike do të kenë nevojë për angazhim në konsolidim fiskal dhe reforma strukturore të mjedisit të biznesit, arsimit, dhe menaxhimin e investimeve publike. Pasiguria politike ndikoi negativisht në ritmin e rritjes ekonomike në vitin 2016, duke e ngadalësuar atë në 2.4 % nga 3.8 % në vitin 2015.

Faktori kryesor shtytës i rritjes ekonomike ishte konsumi familjar, i cili kontribuoi me 3 pikë përqindje (pp), i mbështetur nga rritja në punësim, paga, pensione, dhe kreditime për individë. Konsumi relativisht i pandryshuar i qeverisë kontribuoi vetëm me 0.2 pp në rritjen ekonomike.⁷⁰

Shqetësimi në lidhje me situatën politike ndikoi negativisht investimet, të cilat u tkurrën me 4.3 përqind në krahasim me vitin 2015 dhe kontribute negative me 1.4 pikë përqindje në rritjen ekonomike të vitit 2016, pavarësisht investimeve të konsiderueshme në rrugë. Eksportet neto kontribuan pozitivisht me 0.7 pp në rritjen ekonomike, pasi bilancet tregtare të të mirave dhe shërbimeve, të mbështetura nga rritja në shërbimet e IT dhe transporteve, rezultuan me suficite të vogla. ⁷¹Rritja në vitin 2016 u mbështet kryesisht nga sektori i ndërtimit, ndërsa prodhimi industrial pësoi rënie. Ndërtimi u rrit me 18.5 % nga viti në vit (v-m-v) dhe kontribuoi me 2 pp në rritjen ekonomike, e mbështetur kryesisht nga tre projektet e autostradave të

⁶⁹ Përmbledhje e punimeve - “ Zhvillimi ekonomik dhe regjional, biznesi familjar dhe bashkëpunimi “ Instituti Ekonomik - Shkup, Shoqta për zh

⁷⁰ Përmbledhje e punimeve - “ Zhvillimi ekonomik dhe regjional, biznesi familjar dhe bashkëpunimi “ Instituti Ekonomik - Shkup, Shoqta për zh

⁷¹ Discussion Paper on Entrepreneurship, Growth and Public Policy, Max Planck Institute of Economics, 2005

financuara me fonde publike. Ndërkohë, prodhimi industrial ra me 2.2 % , duke zbritur 0.2 pikë përqindje nga rritje ekonomike, pasi industritë më tradicionale vendase si miniera dhe gurore, industria e ushqimit, veshjeve, energjia elektrike dhe furnizimi me gaz, dhe prodhimi i metaleve bazë dhe produkteve minerale jo-metalore, të cilat përbëjnë më shumë se gjysmën e prodhimit industrial, shënuan rënie në krahasim me vitin 2015. Deficiti fiskal në vitin 2016 u reduktua, kryesisht për shkak të mos-realizimit të shpenzimeve kapitale.

Deficiti ra në 2.6 % të PBB-së, që është shumë më i ulët se niveli 4 % i parashikuar në rishikimin e dytë të buxhetit. Rënia lidhet kryesisht me një ekzekutim të ulët të shpenzimeve kapitale në kontekstin e një cikli të zgjatur zgjedhor. Totali i të ardhurave ishte 27.9 % e PBB-së, me 0.9 pp rënie nga viti 2015, kryesisht për shkak të tatimit më të ulët mbi të ardhurat personale dhe kontributeve të lidhura me vendet e punës të krijuara që janë të përjashtuara nga tatimi. Rënia e të ardhurave u shoqërua me një rënie edhe më të fortë prej 1.77 pp të shpenzimeve.

Megjithatë ndryshimi në strukturën e buxhetit e bën atë më pak të qëndrueshëm: realizimi shumë i ulët i shpenzimeve kapitale tani kombinohet me shpenzimet korrente që tejkaluan 90 % të shpenzimeve të përgjithshme publike.⁷²

Maqedoni	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Rritja e PBB-së reale	2.9	3.6	3.8	2.4	2.8	3.3	3.3
Përbërja							
Konsumi	1.4	1.6	3	3.1	2.5	2.1	2
Investimet	0.1	3.8	0	-1.4	0	0.7	1.1
Exportet neto	1.3	-1.7	0.7	0.7	0.3	0.4	0.7
Exportet	2.6	8.2	2.4	5.9	4.3	4	3.9
Importet	1.3	9.9	1.7	5.2	4	3.6	3.2
Inflacioni çmimeve të konsumit	2.8	-0.3	-0.3	-0.2	0.6	1.4	1.5
Të ardhura publike	30.2	29.8	30.5	30	30.3	30.3	30.5
Shpenzime publike	34.2	29.8	30.9	30	35.5	33	32.6
Prej të cilave							
Shpenzime për paga	7.2	7	6.9	6.9	6.8	6.8	6.3
Asistencë sociale	14.5	14.9	14.8	14.5	14.8	14.2	14.3

⁷² <http://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/south-east-europe-regular-economic-report>

Shpenzime kapitale	4.4	4.3	4.4	3	4.1	4.2	4.3
Bilansi fiskal	-3.9	-4.2	-3.6	-2.6	-3.2	-2.7	-2.3
Bilansi primar fiskal	-2.9	-3.2	-2.3	-1.5	-1.9	-1.4	-0.8
Borxhi publik dhe borxhi i garantuar	40.5	45.9	46.4	47.7	50.6	52.5	55.5
Prej të cilëve i jashtëm	25.5	31.9	31.3	33.3	34.7	35.9	37.2
Exportet mallrave	29.2	32.4	33.5	34.3	34.2	34.3	34.5
Importi i mallrave	52	54.1	53.6	53.1	54.5	54.6	54
Exportet neto të shërbimeve	29.2	32.4	33.5	34.3	34.2	34.3	34.5
Bilansi tregtar	52	54.1	53.6	53.1	54.5	54.6	54.6
Fluksi hyrës i remitancave	4.6	4.2	3.8	4	4.2	4.5	4.6
Bilansi i llogarisë korrente	-18.3	-17.6	-16.4	-14.7	-13.6	-12.2	-11.5
Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte	2.2	2.2	2.1	2.1	2	2	1.9
Borxhi i jashtëm	-1.6	-0.6	-2	-3.1	-3	-2.7	-2.1
Rritja reale e kreditim privat	2.8	2.3	2.3	3.6	2.5	2.7	2.9
Norma e papunësisë	64	70	69.4	74.1	74.7	75.1	73.8
Norma e papunësisë të rinjëve	29	28	26.1	23.7	22	20.2	19.4
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës	37.2	37.3	57	56.8	56.	56.7	56.9
PBB-ja për frymë	12.468	12.938	13.360	13.583	13.956	14.355	14.814
Norma e varfërisë	34.3	33.6	32.6	31.7	30.5	23.9	

Një nga efektet më domethënëse të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është pjesëmarrja e tyre në krijimin e PBB-së. Duke pasur parasysh rritjen e shpejtë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, kontributi i tyre në krijimin e produktit të brendshëm bruto po rritet. Produkti i brendshëm bruto si një shumë e vlerës së tregut të produkteve dhe shërbimeve përfundimtare totale të prodhuara në një vend në një periudhë prej një viti, është një tregues i rëndësishëm i zhvillimit të vendit.

Studime të shumta konfirmojnë se pavarësisht nga të mëdha ndërmarrjet gjenerohet nga NVM-të një përqindje në rritje e PBB-së.

4. Ndikimi i NVM-ve në importin

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) kanë një rol ekonomik dhe social shumë të rëndësishëm, për shkak të kontributit të tyre në funksionimin e rrjetit ekonomik dhe në krijimin e vendeve të punës. Këto kontribute janë shumë të vlershme në kushtet e krizës dhe të rritjes së papunësisë.

Sidomos në RMV zhvillimi i NVM-ve mund të kontribuojë në përballimin e sfidave të shumta të lidhura me zhvillimin ekonomik, efektet e pabarazisë, nivelin e lartë të papunësisë, rritjen demografike dhe nevojën për ndryshime strukturale.⁷³

Zhvillimi i NVM-ve ofron shumë mundësi punësimi, që mund të ndihmojnë në zvogëlimin e nivelit të papunësisë dhe në përballimin e sfidave demografike të këtyre popullatave, të cilat janë në rritje të shpejtë. Përveç kësaj, zhvillimi i sektorit të NVM-ve mund të kontribuojë në përforcimin e konkurrueshmërisë dhe të prodhueshmërisë, duke nxitur njëkohësisht rritjen e të ardhurave globale dhe të ardhurave për frymë.⁷⁴

Ky zhvillim do të promovojë edhe transformimin struktural të sektorit të NVM, për shkak të lidhjes së tij me inovimin dhe zhvillimin teknologjik. Roli i sektorit privat, e posaçërisht i NVM-ve ka qenë relativisht i dobët. Pavarësisht kësaj, RMV-ja është ende në fazën e tranzicionit ku ndërmarrësia dhe krijimi i bizneseve të vogla pritet të luajnë rol të rëndësishëm në rrugën drejt një ekonomie moderne të tregut të lirë dhe si rrjedhim edhe drejt zhvillimit dhe rritjes ekonomike.⁷⁵

RMV vuan nga bilanci negativ i pagesave ku importet dominojnë dukshëm eksportet. Kjo është kryesisht për shkak të faktit që NVM-të e RMV-s nuk janë aq konkurrense në nivel ndërkombëtar. NVM-të eksportuese të dobëta, jo konkurruese, pengojnë kontributin e mëtutjeshëm të NVM-ve në BPV, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike në përgjithësi. Për shkak të mjedisit jo të favorshëm për biznes që ka dominuar në të kaluarën, të mungesës së kulturës kreative të ndërmarrësisë dhe mungesës së investimeve në Hulumtim dhe Zhvillim, RMV ka mungesë të firmave inovative me rritje të shpejtë, të cilat janë kontribuesit kryesor në krijimin e vendeve të punës në ekonominë e zhvilluara perëndimore.

⁷³ Banka Botërore (2010). Raporti i të bërit biznes 2010: Profili ekonomik: Kosovë. Banka Botërore, Washington

⁷⁴ Prof.Asoc.Dr.Besnik Krasniqi, Prof. Dr. Enver Kutllovci, Prof.Asoc.Dr.Petrit Gashi, Prof.Dr. Muhamet Mustafa “ Biznesi i vogël dhe i mesëm” Krijimi, menaxhimi dhe rritja e bizneseve.

⁷⁵ Prof.Asoc.Dr.Besnik Krasniqi, Prof. Dr. Enver Kutllovci, Prof.Asoc.Dr.Petrit Gashi, Prof.Dr. Muhamet Mustafa “ Biznesi i vogël dhe i mesëm” Krijimi, menaxhimi dhe rritja e bizneseve.

Mbi 50% e të gjitha NVM-ve që operojnë në sektorin tregtar karakterizohen me investime të vogla dhe joproductive. Ky model i pasuar me qasjen kopjuese “edhe unë” të bizneseve të reja, kufizon kapacitetin e sektorit të NVMve për gjenerimin e vendeve të punës. Në kuptim të zhvillimit të politikave, raporti “Indeksi i Politikave për NVM-te 2009” tregon se RMV për arsye të ndryshme, ende është në fazën e kompletimit të kërkesave themelore institucionale, ligjore dhe rregullative që kanë të bëjnë me politikat e NVM-ve.

5. Ndikimi i NVM-vë në export

Republika e Maqedonisë përdor përkufizim unik kurse NVM, Neni 470 për klasifikimin e subjekteve tregtare në Ligjin për kompanitë tregtare nga viti 2004, e përcakton përkufizimin në ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme. Ky përkufizim është harmonizuar me përkufizimin e BE (Rekomandimi i BE 2003/361) përkritazi me pragjet për numrin e të punësuarve, por përcakton edhe kritere shtesë për klasifikimin e ndërmarrjeve.⁷⁶

Republika e Maqedonisë ka një ambient relativisht të mirë afarist, por ai mundet dhe, gjithsesi, duhet të përmirësohet. Sipas Raportit për konkurrencë globale, për vitet 2016- 2017, të publikuar nga Forumi ekonomik botëror , në të cilin është identifikuar indeksi i konkurrencës së 140 shteteve, i llogaritur në bazë të 12 faktorëve siç janë: niveli i produktivitetit të vendit, duke përfshirë institucionet, infrastrukturën, mjedisin makroekonomik, shëndetësinë, arsimin, zhvillimin e tregut të financave, gatishmërinë teknologjike, madhësinë e tregut, inovacionin, duke përfshirë edhe shkallën e përgjithshme tatimore, e cila e paraqet shumën e tatimeve dhe kontributeve të cilat patjetër duhet të paguhet nga biznesi. R. e Maqedonisë, me riorganizimin e sistemit të vet tatimor në vitin 2008, arriti të vendosë një shkallë tatimore totale prej 7.4%, me Strategjinë për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021 të cilën radhitet ndër vendet me shkallë më të ulëta tatimore në botë. Banka botërore në raportin e vet të fundit “Doing biznis”për vitin 2017 e radhiti Maqedoninë në 10 më të mirët në botë dhe në 5 të parët në Evropë, sipas kushteve për zhvillimin e biznesit.⁷⁷

⁷⁶ Prof.Asoc.Dr.Besnik Krasniqi, Prof. Dr. Enver Kutllovci, Prof.Asoc.Dr.Petrit Gashi, Prof.Dr. Muhamet Mustafa “ Biznesi i vogël dhe i mesëm” Krijimi, menaxhimi dhe rritja e bizneseve.

⁷⁷ Po aty

Qasja në financa ka rëndësi kyçe për themelimin, qëndrueshmërinë, rritjen dhe zhvillimin e biznesit të NVM. Si burime të i preferuara financimi të rritjes së kompanive evropiane shfrytëzohen kreditë bankare. Megjithatë, problemi më serioz me të cili përballen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është pikërisht qasja në burimet përkatëse të financimit. Investuesit dhe bankat shpesh janë të përmbajtura në financimin e ndërmarrjeve dhe biznese të vogla të reja për shkak të pranisë së theksuar të rrezik. ⁷⁸

Për më shumë se një dhjetëvjeçar, RMV ka pasur një bilanc shumë të lartë negativ tregtar. Eksporti ka qenë i ulët, kurse importi ka qenë shumë i madh (Tabela 1.1). Eksporti i mallrave dhe shërbimeve arriti kulmin në mbi €900 milionë në vitin 2011, duke përbërë kështu rreth 20% të PBB-së. ⁷⁹

Që nga fillimi i vitit 2000, eksporti është rritur në mënyrë mbresëlënëse, ndonëse nga një bazë shumë e ulët. Prania në rritje e eksportit të mallrave dhe shërbimeve të RMV-së më pas vazhdoi në dhjetëvjeçarin tjetër, me kërcimin më të lartë prej 35% rritjeje të eksportit në vitin 2010.

Pjesëmarrja e tyre në PBB përgjatë kësaj periudhe u rrit nga 5% në vitin 2007 në 7% në vitin 2011. Ngjashëm, eksporti i shërbimeve pati një trend rritjeje, nga 10% e PBB në vitin 2007 në 12% në vitin 2011. Në anën tjetër, importi gjatë vitit 2011 kaloi shifrën prej €3 miliardë, duke përbërë kështu mbi 65% të PBB-së RMV-së .

Importi ka pësuar një rritje njësoj të shpejtë, me një shkallë prej 20% gjatë viteve të fundit (përveç vitit 2009, si pasojë e krizë financiare botërore, e cila u ndje edhe sa i përket eksportit). Mesatarja e shkallës së mbulimit të importit, domethënë eksporti i mallrave si përqindje e importit, përgjatë pesë viteve të kaluara qëndroi në 10.7%. Bilanci tregtar që rezulton nga kjo është tepër negativ, duke tejkaluar €2 miliardë në vitin 2011, apo 45% të PBB-së. Ajo çfarë i përkeqëson gjërat edhe më shumë është se ky hendek po zgjerohet vazhdimisht (me përjashtim të vitit 2009)⁸⁰

⁷⁸ Po aty

⁷⁹ Prof.Asoc.Dr.Besnik Krasniqi, Prof. Dr. Enver Kutllovci, Prof.Asoc.Dr.Petrit Gashi, Prof.Dr. Muhamet Mustafa “ Biznesi i vogël dhe i mesëm” Krijimi, menaxhimi dhe rritja e bizneseve.

⁸⁰ Series 3: Economic Statistics, External Trade 2010,Shkup

KAPITULLI I 5

1. ANALIZA E RAPORTEVE VJETORE TË MARA NË KOMUNËN E TETOVËS DHE ZHELINËS PËR HAPJEN E NDËRMARRJEVE TË VOGËLA DHE TË MESME NË RAJONIN E POLLOGUT PËR PERIUDHËN 2010-2020

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kanë një histori shumë të gjatë, ndërsa zhvillimi i tyre është i shënuar me zgjerimin dhe stagnimin e tyre të kohëpaskohshëm. Ndoshta ekspansionin më të madh, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme e mbërrijnë në fillim të viteve të 70' të shekullit XX. Risi është se prej që atëherë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me sukses përballojnë sfidat e konkurrencës dhe të globalizimit.

Ndonse një pjesë e vogël e këtyre ndërmarrjeve bazohet në teknikën dhe teknologjinë tradicionale, pjesa më e madhe e tyre aplikon një teknologjitë re dhe të lartë si dhe një organizim modern.

Thelbësore është se NVM demonstrojnë një shkallë të lartë të inovacioneve, fleksibilitetit dhe adaptim ndaj ndryshimeve, të cilat ndodhin në rrethinë. Edhe pse janë të orientuara kah tregu lokal NVM kanë rol gjithnjë e më të madh edhe në këmbimet ndërkombetare. Hulumtime të shumta dëshmojnë se pjesmarrja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme rritet në raport me ndërmarrjet e mëdha. Kjo nuk do të thotë se ndërmarrjet e mëdha e humbin kuptimin.

Në fakt ndërvartësia midis tyre bëhet gjithnjë e më e madhe. Rastet kur ekonomitë nacionale arrijnë të gjejnë kombinim optimal në mes të ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha janë gjithnjë e më të mëdha. Bashkëjetesa e bizneseve të vogla dhe atyre të mëdha kanë nxitur debate në qarqet akademike për një kohë të gjatë. Si rrjedhojë, një numër i qasjeve sa i përket këtij raporti është present në literaturë.

Disa besojnë se bizneset e vogla përpiqen ta shmangin ballafaqimin e drejtpërdrejtë me bizneset e mëdha në treg, ndërsa në anën tjetër disa mendojnë se bizneset e vogla janë konkurrentë të drejtpërdrejtë të kompanive të mëdha në tregjet e njejta të produkteve dhe shërbimeve.

Pikpamja e parë bazohet në të ashtëquajturen 'teorit e dualitetit' në bazë të së cilës bizneset e vogla realizojnë aktivitete të ndryshme nga të mëdhatë, dhe si rrjedhojë nuk janë konkurrent të bizneseve të mëdha.

Ndryshe kjo qasje njihet edhe si ‘teoria e Niçeve’ apo strateegjike. Ndërsa sipas qasjes së dytë shpërndarja e bizneseve sipas madhësisë është rezultat i posedimit të ndonjë resursi të kufizuar specifik të prodhimit, apo edhe të ndonjë përparësie tjetër si e lidhur me eficiencën e firmës apo fleksibilitetin e saj. Sipas regjistrimeve të marra në Komunë e Tetovës dhe Zhelinës, për periudhën 2010-2020 janë hapur këta lloje biznesesh dhe nr i tyre janë si më poshtë.

Tabela 1. Bizneset e regjistruara në Tetovë dhe Zhelina

Lloji I biznesit	Numri I tyre	Numri I shprehur në %
Biznese individuale	106,858	88,62%
Ortakëri e përgjithshme	3,440	2,85%
Ortakëri e kufizuar	86	0,07%
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K)	9,060	7,52%
Shoqëri aksionare	391	0,32%
Kompani të huaja	599	0,50%
Ndërmarrje shoqërore	23	0,02%
Ndërmarrje publike	10	0,01%
Kooperativa bujqësore	76	0,06%
Biznese nën juridiksionin e AKP	33	0,03%
	= 120,576	= 100%

2. Metodologjia

Në këtë punim studimor do të shfrytëzohet një metodologji e tillë hulumtimi që nisët nga e përgjithshmja tek konkretja. Në radhë të parë jepen objektivat e përgjithshme dhe specifike se ç’farë pretendohet të arrihet në këtë studim, metodat dhe teknikat që do të përdoren, të dhënat e përgjithshme dhe specifike të këtij studimi, analiza e tyre si dhe në fund interpretimi i rezultateve. Rezultatet e gjetura nuk kanë për qëllim përgjithësimi.

Një ashtu do të përdoren Metodatat statistikore-përmes tabelave dhe grafikoneve do të jepen të dhëna relevante sasiore rreth numri të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të cilat gjenden në Rajonin e Pollogut, dekadën e fundit 2020-2010 përfshirë këtu edhe fshatrat për rret.

Për të realizuar objektivin e studimit dotë përdoret analiza përshkruese, metoda sintetike me qëllim të evidentimit dhe analizës së gjendjes dhe faktorëve që përcaktojnë nevojën e zhvillimit të NVM-ve në Rajonin e Pollogut.

Thënë ndryshe pjesa teorike synon që të paraqës mënyrën e organizimit, krijimit dhe objektivave që kanë këta ndërmarrje në vendin tonë, si e realizojnë ata financimin dhe cilët janë burimet e financimit. Do të jepet një analizë mbi literaturën ekzistuese të huaj dhe atë shqipëtare rreth ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme dhe kuadrin ligjor të RMV-vë që mundosëon hapjen e tyre.

Në realizimin e këtij punimi do të përdorim të dhëna primare dhe sekondare. Të dhënat primare konsistojnë në realizimin e pyetësorëve drejtuar individëve të ndryshëm. Këta kërkime janë para të domosdoshmë për matjen e nevojshme dhe sa më të afërt me realitetin e rajonit tonë. Në të dhënat sekondare kemi publikimet e administratës tatimore të ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme, analizimin e Buletinëve të Ministrisë së Financave, Banka e Popullore e Maqedonisë etj.

Ky punim sikur mund ta shohim ka një gërshetim instrumentesh kërkimore. Themi se do të përdorim metoden përshkruese ose narrative për të dhënë informata teorike jo vetëm mbi ndërmarrjet e vogëla dhe të mesme por edhe mbi burimet, financimin dhe tatimin që kanë këta ndërmarrje.

Qëllimi i këtij studimi është analiza empirike e variablave kryesore që na mundësojnë të shikojmë performancën e Ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme në Rajonin e Pollogut dhe rritjen e tyre ekonomike në Rajonin e Maqedonisë së Veriut.

Me qëllim që të fitojmë një njohuri rreth ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme në Rajonin e Pollogut do të sjellim një pilot projekt të vogël ku do të flasim për hulumtime të ndryshme dhe analiza të hollësishme ndaj invoacionit në këta ndërmarrje.

Si metodë kryesore do të përdorim pyetësorin të themeluar me 15 pyetje të tipit të hapur dhe tipit të mbyllur. Kompanitë e hulumtuara janë 20 dhe kanë rreth 250 të punësuar. Pjesa e parë e pyetësorit do të themelohet me informata bazike rreth kompanisë kursë pjesa e dytë është përbërë me pyetje më të komplikuar.

3. Metoda kualitative – biseda të lira me analist të ekonomisë që flasin rreth ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme

a) A mund të na flitni dicka rreth stimulimit të rritjes ekonomike?

Stimulimi i rritjes ekonomike bën pjesë në objektivat më të rëndësishëm të politikave publike. Debatet politike, ekonomike e sociale vazhdojnë të kenë në thelbin e tyre “gjetjen e mjeteve dhe mënyrave për të nxitur rritjen ekonomike si rruga kryesore e zhvillimit ekonomik.” E shprehur si përqindje në raport me PBB, rritja ekonomike paraqitet nga ekonomistët dhe politikanët si “rruga e vetme që të con drejt progresit social dhe mirëqënies”, si “çelësi i vetëm për krijimin e pasurisë së individëve dhe shteteve”, si “pasuri që, pastaj, mund të përdoret për shërbime të ndryshme publike apo të rrishpërndahet për ata që kanë nevojë në kuadrin e politikave sociale.” PBB është barometri i pasurisë kombëtare dhe i kapaciteteve tona për progres social dhe mirëqënie.

b) A jeni të mendimit se rritja ekonomike ndikon në shëndetin e cdo ekonomie?

Rritja ekonomike është kryefjala e shëndetit të çdo ekonomie, e mundësive për financa të stabilizuara, e oportuniteteve të punësimit dhe reduktimit të papunësisë, e mundësive të rrijës së konsumit, e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm etj. Institucionet kryesore ndërkombëtare, si FMN apo Banka Botërore, apo dhe çdo qeveri, e kujtudo vendi qoftë, krenarinë e suksese të saj, apo përballjen me kritikën e ballafaqon me shifrat e rritjes ekonomike që realizon. Me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), llogaritet borxhi publik, deficitin buxhetor, investimet publike, investimet e huaja direkte, ngarkesa fiskale etj

c) A mund të na tregoni rreth rritjes ekonomike dhe konvergjenca me ekonomitë rajonale dhe atë Europiane?

Kur analizojmë strukturën e ekonomisë, efikasitetin, konkurrueshmërinë, nivelin e pagave, çmimet, etj., pak e lidhim këtë me politika specifike, që garantojnë konvergjencën dhe na afrojnë me rajonin dhe BE. Në mjaft tregues thelbësorë ekonomikë, financiarë dhe socialë jemi prapa mesatares rajonale dhe europiane.

Duhet një rritje ekonomike e qëndrueshme mbi 6-7% që të krijojmë mundësi përafrimi apo konvergjenca, sidomos me mesataren e BE. Sipas Bankës Botërore, me një rritje ekonomike prej 4-4.2% RMV-s i duhen rreth 36 vite që të arrijë mesataren e të ardhurave mesatare për frymë të vendeve të BE-së, ndërkohë që me një rritje ekonomike të qëndrueshme prej 6% i duhen rreth 25 vite.

Duke iu referuar parashikimeve afat-mesme makroekonomike, RMV planifikon që rritja ekonomike në nivelet 5-6% mund të jetë e realizueshme vetëm mbas viteve 2020-2022. Sipas raportit të “Economist Intelligence Unit” (2018), edhe pse kanë kaluar thuajse tri dekada që nga fillimi tranzicionit në Europën Qendrore dhe Lindore, progresi në konvergjencën e nivelit të të ardhurave me vendet më të zhvilluara të Europës ka qenë modest, veçanërisht që prej krizës financiare globale në 2008-n.

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë bërë hapa pas që nga 1989. Diferenca midis nivelit mesatar të të ardhurave të tyre dhe BE 15 ishte më e thellë në 2017-n se sa në 1989. Raporti veçon tri faza të këtij tranzicioni. Faza e parë, gjatë viteve '90, veçanërisht në gjysmën e parë të dekadës, u shënjua nga një recesion i thellë edhe nën ndikimin e konflikteve. Pas vitit 2000, pati një rimëkëmbje të shpejtë dhe përshpejtim të arritjes së nivelit të BE 15. Por kjo zgjati deri në krizën globale financiare të 2008-s. Pas kësaj, ritmi i konvergjencës u ngadalësua.

4. Metoda kualitative – biseda të lira me professor universitar në Drejtimin Ekonomik – Universiteti i Tetovës dhe Universiteti i Europës Juglindore.

a) A keni mundësi të na flitni dicka rreth rritjes ekonomike dhe modeli i ri ekonomik a k atë bëjë me kontributin e sektorit të ndryshmëm në PBB

Këtë debat e ka hapur që në vitin 2005 Banka Botërore me studimin mbi faktorët e rritjes së qendrueshme dhe zhvillimit në RMV. Prej atëherë është diskutuar në RMV, por ende pa marrë një përgjigje me natyrë strategjike: cilat janë objektivat dhe strategjitë për një ndryshim strukturor në kontributin e degëve apo sektorëve në PBB për 10 apo 15 vitet e ardhëshme?

Sa dhe si do t'i zëvendësojmë “gropat” e shkaktuara në ecurinë dhe stabilitetin e PBB nga rrudhja e sektorit të ndërtimit, zvogëlimi i remitancave, kufizimi i mundësive të privatizimeve?”

Sa për qind do ta kemi të varur rritjen ekonomike nga ndryshimet strukturore në ekonominë tonë?

A kemi tashmë një strategji të qartë të zhvillimit ekonomik e financiar për 20 vitet e ardhëshme me degë e sektorë prioritarë të përcaktuar?”

Pa një përgjigje direkte efëcente në këto çështje është e zorshme të jemi plotësisht të bindur se politikat tona ekonomike, klima e biznesit, politikat fiskale e buxhetore etj., shkojnë në

drejtimin e duhur. E rëndësishme është mbizotërimi i filozofisë, që duket se tashmë është kuptuar: rritja duhet të udhëhiqet nga investimet dhe eksportet dhe jo nga konsumi dhe importet.

b) Na shpjegoni rritjen ekonomike kundrejt zhvillimit ekonomik

Bruto Produkti Vendor (BPV) është një term që ekonomistët e përdorin shpesh kur krahasojnë gjendjen e ekonomisë së një shteti me ekonominë e një shteti tjetër apo edhe ekonominë e një shteti të vetëm në periudha të ndryshme. BPV, që njihet ndryshe edhe si GDP (nga anglisht Gross Domestic Product), e matë vlerën e mallrave dhe shërbimeve që janë prodhuar dhe shitur në treg brenda një periudhe të caktuar, zakonisht brenda një viti.

Për të llogaritur BPV marren për bazë katër elemente e ato janë:

Konsumi – shpenzimet që i kanë bërë qytetarët;

Investimet – shpenzimet që i kanë bërë firmat;

Shpenzimet qeveritare – çdo shpenzim që e ka bërë qeveria (paga, mallra, investime etj); dhe

Eksporti neto – mallrat që janë importuar minus mallrat që janë eksportuar.

Zhvillimi ekonomik, për dallim prej rritjes ekonomike, përkufizohet si proces i rritjes së volumit të prodhimit por merr parasysh edhe përmirësimin e teknologjisë, përmirësimin e standardit të jetesës, ndryshimeve institucionale etj. Shkurt, është progresi në strukturën socio-ekonomike të vendit.

Indeksi i Zhvillimit Njerëzor është matësi më i mirë i mirëqenies së qytetarëve. Ky e merr parasysh zhvillimin e përgjithshëm në ekonomi sa i përket kushteve të jetesës, shëndetësisë, arsimit, krijimit të mundësive, të ardhurave për kokë banori, zhvillimit të infrastrukturës dhe shumë të tjera.

c) Na bëni një përmbledhje rreth rritjes ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Rritja ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor është forcuar në rreth 3.5 përqind. Parashikimet për rritjen ekonomike të shumicës së vendeve të rajonit për vitin 2018 janë rishikuar me rritje. Kosova dhe Shqipëria pritet të kenë një rritje ekonomike prej 4 përqind këtë vit. Parashikimi i rritjes ekonomike të Malit të Zi u rishikua me rritje me 1 pikë përqindje, duke arritur në 3.8 përqind, megjithëse dhe kjo vlerë është përsëri më e ulët se viti i kaluar.

Bosnje-Herzegovina vijon të ketë rritje të qëndrueshme në rreth 3.2 përqind. Pas ngadalësimit që pësoi vitin e kaluar si rezultat i kushteve të motit, ekonomia e Serbisë e ka rimarrë veten duke arritur një rritje ekonomike prej 3.5 përqind.

Me rikthimin e besimit tek investitorët, edhe Maqedonia përjetoi forcim të rritjes ekonomike në 2.5 përqind. Rritja e investimeve publike dhe konsumit stimuloi rritjen ekonomike. Mbështetur në reformat tatimore dhe përshpejtimin e ritmeve të rritjes ekonomike, të ardhurat e larta nga tatimet krijuan hapësirë fiskale, të cilën disa vende nxituan ta shfrytëzojnë për shpenzime korrente dhe investime kapitale.

Rritja e investimeve publike është shenjë e mirëpritur, por për të qenë e suksesshme ajo duhet të mbështetet nga përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të shpenzimeve publike. Rritja e madhe e shpenzimeve sociale të pashenjëstruara dhe pagave të sektorit publik ka patur efekt të menjëhershëm në ritmet e rritjes ekonomike në disa vende për shkak të rritjes së shpejtë të konsumit dhe kredisë për individë. Por këto efekte janë të përkohshme dhe të kushtueshme: në periudhë afatgjatë ato shkaktojnë rritje të vulnerabilitetit fiskal.

Në gjysmën e parë të vitit 2018 u krijuan mbi 90,000 vende pune, kryesisht në sektorët e industrisë dhe shërbimeve. Por reagimi i përgjithshëm i tregut të punës ndaj rritjes ekonomike ishte më i ngadaltë nga sa pritej, duke reflektuar në këtë mënyrë natyrën e përkohshme të stimujve të udhëhequr nga konsumi, si dhe nga rritja e inaktivitetit në tregun e punës. Rënia e papunësisë në disa vende ka ardhur për shkak të inaktivitetit dhe emigracionit dhe jo si rezultat i hapjes së vendeve të reja të punës.

Deformimet strukturore në tregjet e punës manifestohen në nivelin e lartë të pabarazive rajonale dhe gjinore në rezultatet e tregut të punës. Përmirësimi i stimujve për rritjen e pjesëmarrjes në forcën e punës do t'i japë shtysë jo vetëm krijimit të vendeve të reja të punës por edhe rritjes ekonomike.

Vendet me ritme më të larta të rritjes ekonomike e nxitën rritjen kryesisht nëpërmjet investimeve dhe eksporteve. Rritja e investimeve private çoi në një rritje më të lartë ekonomike. Por për të mbështetur rritjen ekonomike nevojiten më shumë investime në sektorët e tregtueshëm. Ndërkohë që konkurrenca ndërmjet tregjeve në zhvillim po bëhet më e ashpër, stabiliteti politik, një mjedis rregullator dashamirës ndaj biznesit, infrastruktura cilësore dhe një forcë pune e kualifikuar janë disa nga faktorët që do të ndikojnë në thithjen e investitorëve.

Meqenëse kreditimi udhëhiqet kryesisht nga kredia për individë, krijimi i një sektori financiar më të diversifikuar dhe që favorizon rritjen ekonomike do të ndihmonte gjithashtu në tërheqjen e investitorëve vendas dhe të huaj. Rritja e nivelit të eksporteve përbën gjithashtu domosdoshmëri për garantimin e rritjes ekonomike afatgjatë. Disbalancat e jashtme kanë vijuar

të jenë të larta, por të qëndrueshme. Bosnje-Hercegovina, Maqedonia dhe Serbia kanë përjetuar rritje të shpejtë të eksporteve të tyre. Por rritja e konsumit dhe projektet e mëdha infrastrukturore i kanë dhënë hov rritjes së importeve.

Rritja e qëndrueshme e nivelit të eksporteve do të ndihmojë në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, nxitjen e rritjes ekonomike dhe uljen e varfërisë. Mbështetja mund të vijë edhe nga integrimi rajonal: Meqënëse shumica e eksporteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën, integrimi rajonal në zinxhirët evlerës të Bashkimit Evropian mund të sjellë përfitime domethënëse – dhe pa kompensime.

Plani Shumëvjeçar i Veprimit (MAP) për krijimin e një zone ekonomike rajonale është një hap në drejtimin e duhur. Perspektiva pozitive e rritjes ekonomike ndeshet me rreziqe të jashtme dhe të brendshme.

Shtrengimi i mundshëm i kushteve të financimit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit përbën një rrezik me ndikim negativ, veçanërisht në vendet që kanë disbalanca të jashtme dhe fiskale. Duke qenë se tregjet e brendshme të bonove të qeversisë shpesh nuk janë të mirëzhvilluara, vendet e Ballkanit Perëndimor janë të ekspozuara ndaj rritjes së normave të interesit në tregjet ndërkombëtare. Rritja e fortë ekonomike e vendeve të rajonit varet gjithashtu nga stabiliteti politik në vend dhe rajon, i cili përcakton shpejtësinë e reformave strukturore.

Zbutja e këtyre rreziqeve të jashtme dhe të brendshme kërkon angazhim maksimal në procesin e konsolidimit fiskal dhe përshpejtimin e reformave strukturore.

a) Analiza komperative midis Shqipërisë, Kosovë dhe RMV

Të shikojmë relacionin e Maqedonisë me Kosovën, Kosova është një ndër shtete më të reja në rajon, është vendi më i ri e të cilin ne në punimin tim do të realizojmë një krahasim të normave tatimore.

Reformat fiskale të cilat janë të aplikuara në Republikën e Kosovës e ka bërë këtë vend një ndër vendet më atraktive për investime shkaku se ofron norma më të favorshme tatimore, dhe burimet të cilat ka ky vend pra burime të pashterura janë forca që rëndisin Kosovën në radhën e parë që sigurojnë kushte të favorshme investimesh dhe garancione për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Për ata që do të përdorin këtë punim, studimi jonë është i rëndësishëm se do të plotësojë hendekun e informacioneve në lidhje me krahasimin e normave tatimore midis vendeve rajonale.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor pati rritje më të shpejtë ekonomike në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015: forcimi i rritjes në Serbi dhe Shqipëri, si dhe rritja e qëndrueshme në Bosnjë dhe Hercegovinë, kompensoi zgjerimin më të dobët në Mal të Zi dhe IRJ të Maqedonisë dhe ngadalësimin të lehtë në rritjen e Kosovës. Rimëkëmbja e fuqishme e prodhimit në Serbi dhe Shqipëri drejtoi zgjerimin e ekonomisë së rajonit të Ballkanit Perëndimor në vitin 2016. Vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6)⁸¹ karakterizohen nga dy modele të ndryshme të rritjes ekonomike.

Nga njëra anë, ekonomitë e Serbisë dhe Shqipërisë, të cilat përbëjnë më shumë se gjysmën e PBB-së së rajonit, përjetuan një përshpejtim të qëndrueshëm pasi përpjekjet e vazhdueshme për konsolidim fiskal dhe reformat strukturore çuan në rigjallërim të konsumit dhe investimeve private dhe në rritjen e eksporteve.

Nga ana tjetër, Kosova, IRJ e Maqedonis dhe Mali i Zi përjetuan ngadalësim të rritjes ekonomike, ndërsa investimet u ngadalësuan për shkak të pasigurisë politike në IJR të Maqedonisë, dhe disbalancat e jashtme u zgjeruan në Mal të Zi. Ndërkohë që, Bosnje dhe Herzegovina (BH), ekonomia e dytë më e madhe në rajon, po rritet në mënyrë të qëndrueshme pavarësisht progresit relativisht të ngadaltë në reforma strukturore, përshkak se çmimet e ulëta të importit po mbështesin rritjen e konsumit.

	2015	2016	2017	2018
Shqipëria	2.6	3.2	3.5	3.5
Bosnja dhe Hercegovina	3.0	2.8	3.2	3.7
Kosova	4.1	3.6	3.9	4.2
Maqedonia	3.8	2.4	2.8	3.3
Mali i zi	3.4	2.1	3.3	3.0
Sërbia	0.8	2.8	3.0	3.5

Trajektoret e ndryshme të politikave fiskale në vendet në rajon.

Shumica e vendeve ngushtuan deficitet e tyre fiskale në vitin 2016; por ky trend i përbashkët nuk pasqyron trajektoret e ndryshme të politikave. Deficiti fiskal mesatar i rajonit u ngushtua nga 3.5 % e PBB-së në vitin 2015 në 2 % në vitin 2016 (Figura 5.). Deficiti i Serbisë ra nga 3.7 % e PBBsë -së në 1.4 % ndërsa ai i Shqipërisë ra nga 4.6 % në 2.2 %.

⁸¹Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, IRJ e Maqedonisë, Mali i Zi, dhe Serbia.

Deficiti u ngushtua gjithashtu edhe në IRJ të Maqedonisë, nga 3.5 % e PBB-së në 2.6 %, dhe në Kosovë në 1.3 % . Ai mbeti i ulët në Bosnjë - Hercegovinë, ku vlerësohet të ketë qenë më pak se 1 % e PBB-së.

Megjithëse deficiti i Malit të Zi ra përkohësisht nga 7.9 % e PBB-së në 3.9 % në vitin 2016 për shkak të vonesave në ndërtimin e autostradës Bar-Boljare, ai përbën ende rrezik për qëndrueshmërinë fiskale afat mesme të vendit/ Rritja ekonomike në vitin 2016 u forcua në nivelin 3.2 % dhe për periudhën 2017-19 parashikohet që të jetë mesatarisht 3.6 % , e nxitur nga investimet private në projektet e mëdha energjitike të financuara nga IHD-të, rigjallërimi i konsumit dhe nga rritja e eksporteve të shërbimeve.

- Rritja ekonomike krijoi vende të reja pune.
- Pozicioni fiskal vijoi të përmirësohet si rezultat i mbledhjes së më shumë të ardhurave dhe kufizimit të shpenzimeve.
- Vazhdimi i përpjekjeve të konsolidimit fiskal për të reduktuar borxhin dhe detyrimet e parashikuara, reformat strukturore veçanërisht në sektorin e energjisë dhe atë financiar, menaxhimi më i mirë i investimeve publike, dhe reforma në drejtësi janë ende me rëndësi kritike për nxitjen e besimit dhe rritjen ekonomike.⁸²

Ekonomia e Shqipërisë u zgjerua me 3.2 % në vitin 2016, e mbështetur nga kërkesa e fortë e brendshme. Dy projekte të mëdha në sektorin e energjisë me financim të huaj privat - gazsjellësi TAP dhe hidrocentrali i Devollit në jug të vendit dhe rigjallërimi i konsumit ndihmuan në ruajtjen e vullit pozitiv të rritjes ekonomike. Përmirësimi i rezultateve të tregut të punës dhe lehtësimi i kushteve të kreditimit ndikuan pozitivisht në konsumin privat.

Pas rënies për pesë tremujorë radhazi, konsumi publik pati një kontribut të vogël pozitiv në rritjen ekonomike, duke reflektuar konsolidimin gradual fiskal më shumë gjatë gjysmës së dytë të vitit. Ndërsa eksportet e shërbimeve u rritën me 25.4 % , kontributi i tregtisë së mallrave ishte negativ.

Prodhimi i industrisë përpunuese u rigjallërua, por industria në përgjithësi u ndikua nga çmimet jo të favorshme të lëndëve të para. Shërbimet qenë shtytësi kryesor i rritjes ekonomike, të ndjekura nga sektorët me përdorim më intensiv të punës, ndërtimi dhe bujqësia. Rritja ekonomike në vitin 2016 stimuloi krijimin e vendeve të punës.

⁸² <http://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/south-east-europe-regular-economic-report>

Në tremujorin e tretë punësimi u rrit me 5.8 % terma vjetore (v-m-v), i ndikuar kryesisht nga rritja e punësimit në sektorin e shërbimeve (7.4 %) dhe në ndërtim dhe prodhim (5.1 %). Shkalla e pjesëmarrjes së forcës së punës ishte 0.4 pikë përqindjeje (pp) më e lartë se në të njëjtin tremujor në vitin 2015, duke arritur në nivelin 57.2 %.

Norma e papunësisë u reduktua në nivelin 15.2 % , por më shumë se gjysma e personave të papunë kanë qenë të tillë prej një periudhe afatgjatë. Pagat nominale vijuan rënien e tyre që kishte filluar në fund të vitit 2013, por pritet që të rriten në vitin 2017 për shkak të përfundimit të periudhës së ngrirjes së pagave në sektorin publik. Politika e kujdesshme fiskale ka mbështetur stabilizimin e borxhit publik.

Deficiti fiskal për vitin 2016 vlerësohet të ulët në 2.2 % të PBB-së, nga 4.6 % në vitin 2015, në linjë me pritshmëritë nga përpjekjet e vendit për konsolidim fiskal të mbështetura nga rregulli fiskal. Qeveria qendrore në vitin 2016 regjistroi një suficit primar fiskal prej 0.2 % të PBB-së. Konsolidimi u mbështet nga përmirësimet si në mbledhjen e të ardhurave dhe në kontrollin e shpenzimeve. Të ardhurat u rritën me 0.4 pp të PBB-së në 2016 (v-m-v) në sajë të rritjes së tyre nga pothuajse të gjitha kategoritë e taksave.

Me vijimin e konsolidimit fiskal, shpenzimet publike (me përjashtim të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura) në vitin 2016 u reduktuan ndjeshëm me 2 pp (v-m-v). Gjithashtu edhe ekzekutimi i shpenzimeve kapitale ishte më i ulët se plani, me realizim 97.6 % të nivelit të planikuar.

Si rezultat i konsolidimit fiskal, borxhi publik filloi të bjerë në vitin 2016, por mbetet ende i lartë në nivelin 72.7 % të GDP-së.⁸³ Inflacioni ka qenë nën kufirin e poshtëm të intervalit të synuar por ka filluar të rritet. Inflacioni mesatar vjetor ra nga 1.9 % në vitin 2015 në 1.3 % në vitin 2016, posh intervalit të synuar të Bankës së Shqipërisë (BSH) prej 3 ± 1 përqind.

Megjithatë, me rritjen e çmimeve të ushqimeve në Janar 2017, inflacioni gjithashtu filloi të rritet. Në kushtet e vazhdimit të rritjes ekonomike dhe rimëkëmbjes së shfrytëzimit të kapaciteteve të prodhimit, inflacioni tani pritet të konvergojë gradualisht në intervalin e synuar. Politika monetare e BSH vijon të jetë akomoduese.

⁸³ Që nga viti 2015, borxhi i qeverisjes së përgjithshme përfshin edhe faturat e papaguara dhe plotësisht të dokumentuara të qeverive lokale, shumica e të cilave u trashëguan nga bashkitë e reja pas reformës territoriale në Qershor 20

Norma bazë e interesit mbetet në nivelin minimum prej 1.25 përqind, e cila filloi të zbatohet në Prill të vitit 2016, pasi çmimet e ulëta të lëndëve të para dhe hendeku negativ i prodhimit ushtruan presion për uljen e çmimeve. Nga fundi i vitit 2016, transmetimi i politikës monetare u forcua, pasi norma mesatare e interesit për kreditë në monedhën vendase ra në 7.5 % , 0.6 pikë përqindje (pp) nën nivelin e vitit 2015.

Në periudhën e fundvitit kursi real efektiv i këmbimit u mbiçmua me 4.1 % , për shkak të mbiçmimit nominal të lekut Shqiptar (me 0.4 % kundrejt euros) dhe një difference të ngushtë të normës së inflacionit me partnerët tregtarë.

Shqipëria	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Rritja e PBB-së (ndryshimet në %, v-m-v)	1	1.8	2.6	3.2	3.5	3.5	3.8
Përbërja (përqindjet)							
Konsumi	1.4	2.5	-1	0.9	1.1	1.8	1.8
Investimet	-0.6	-1.2	2.8	2.8	2.5	2	1.5
Exportet neto	12.8	3.9	-1	3.7	6.5	6.5	6.1
Eksportet	-7.2	0.9	-0.1	1.6	3.2	3.1	3.3
Importet	-5.6	3	-0.9	2.1	3.3	3.4	2.8
Inflacioni i çmimeve të konsumit ndryshim në përqindje v-m-v, mesatare e periudhës.	1.9	1.6	1.9	1.3	1.5	2.9	3
Të ardhura publike (përqindjet e PBB-së)	24	26.3	26.3	26.7	27.7	27.5	27.5
Shpenzimet publike (përqindje e PBB-së)	29.2	32.3	30.9	28.9	28.8	28.5	28.2
Prej të cilave:							
Shpenzime për paga (përqindje e PBB-së)	5.2	5.1	5.1	4.5	4.6	4.6	4.4
Asistencë sociale (perqindje e PBB-së)	9.5	9.9	9.8	10.1	10.1	10	10

Shpenzime kapitale (përqind e PBB-së)	4.8	4.3	4.4	3.9	4.5	4.4	4.4
Bilansi fiskal (përqindje e PBB-së)	-5.2	-6	-4.6	-2.2	-1.1	-1	-0.7
Bilansi primar fiskal (përqindje e PBB-së)	-2	-3.1	-1.9	0.2	1.2	1.1	1.4
Borxhi publik (përqindje e PBB-së)	66.7	68	69.6	67.8	64.7	64	63.5
Borxhi publik dhe i garantuar (përqindje e PBB-së)	70.4	72.1	73.7	72.7	69.9	67	63.5
Prej të cilave : i jashtëm (përqindje e PBB-së)	5.2	5.1	5.1	4.5	4.6	4.6	4.4
Eksportet e mallrave (përqindje e PBB-së)	9.5	9.9	9.8	10.1	10.1	10	10
Importet e mallrave (përqindje e PBB-së)	4.8	4.3	4.4	3.9	4.5	4.4	4.4
Eksportet neto të shërbimeve (përqindje e PBB-së)	-5.2	-6	-4.6	-2.2	-1.1	-1	-0.7
Bilansi tregtar (përqindje e PBB-së)	-2	-3.1	-1.9	0.2	1.2	1.1	1.4
Fluksi hyrës i remitencave (përqindje e PBB-së)	66.7	68	69.6	67.8	64.7	64	63.5
Bilansi i llogarisë korrente (përqindje e PBB-së)	26.9	39.6	34.2	33.8	34.8	34.2	34.7
Flukest hyrëse të investimeve të huaja direkte (përqindje e PBB-së)	-0.2	3.2	5.1	3.9	3.6	3.6	3.8
Borxhi i jashtëm total si	-16.8	.17.3	-17.3	-18.2	-19.4	-18.5	-17.1

përqindje e PBB-së							
Rritja reale e kreditimi privat (përqind mesatare e periudhës)	7.1	7.3	7.5	7.2	6.9	6.7	6.5
Norma e papunësisë (përqindje, mesatare e periudhës)	-10.5	-12.9	-10.8	-12.1	-13.7	-13	-11.8
Norma e papunës së të rinjëve	9.6	8.1	7.7	7.1	8	6.9	5.3
Shkallja e pjesëmarrjes në forcën e punës	64.4	72.4	74.2	75.5	77.8	80.9	81.7
Norma e papunisë të të rinjëve	29.7	35.6	32.3	28.95	n.a	n.a	n.a
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës	52.5	53.7	55.7	57.5	n.a	n.a	n.a
PBB-ja për frymë PPP	10.255	10.645	10.926	11.276	11.670	12.079	12538
Norma e varfërisë në kufirin përqindja e popullisë	47.2	46.7	46.2	45.5	n.a	n.a	

84

Pavarësisht rënies së eksporteve neto, konsumi dhe investimet udhëhoqën rritjen ekonomike që për vitin 2016 vlerësohet të jetë 3.6 %. Në vitin 2017 rritja ekonomike parashikohet të jetë 3.9 %, e nxitur nga investimet publike dhe konsumi. Deficiti fiskal në vitin 2016 qëndroi i ulët në 1.3 % të PBB-së, i mbështetur nga niveli i lartë të ardhurave dhe mos-ekzekutimi i plotë i shpenzimeve kapitale dhe pavarësisht presionit nga programi për përfitimet e veteranëve.⁸⁵

Përmirësimet në cilësinë e aseteve të bankave dhe normat më të ulëta të interes të kredive kontribuan në rritjen e kreditimit, duke stimuluar kërkesën e brendshme. Diaspora e Kosovës vijon të jetë faktor stimulus për rritjen ekonomike nëpërmjet remitancave, IHD-ve dhe eksporteve të shërbimeve. Ekonomia e Kosovës vlerësohet të jetë rritur me 3.6 % në vitin 2016. Rritja erdhi për shkak të kontributit të konsumit (4.5 pikë përqindje [pp]) dhe rigjallërimit të kërkesës së brendshme të nxitur nga investimet (2.2 pp).

Eksportet neto, megjithatë, patën kontribut negativ me 3.1 pp në rritjen ekonomike - performanca më e mirë e eksporteve të shërbimeve të udhëtimit nuk mundi të përballonte rritjen

⁸⁴ Burimi: Autoritet e Vendit, Vlerësime dhe parashikime të Bankës Botërore.

⁸⁵ <http://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/south-east-europe-regular-economic-report>

e importeve, pasi kërkesa e brendshme për konsum dhe e investime u rrit. Zgjerimi i shëndetshëm i aktiviteteve të tregtisë, transportit, financave, dhe strehimit e shndërroi komponentin e shërbimeve në kontribuesin kryesor të rritjes ekonomike, të ndjekur nga bujqësia dhe industria.

Të dhënat paraprake për vitin 2016 paraqesin përmirësime në shumicën e rezultateve të tregut të punës. Megjithëse përmirësimet janë të nxitura kryesisht nga rritja e vazhdueshme ekonomike, madje edhe në kushtet e rigjallërimit të tregut të punës, numri i të punësuarve është ende më i ulët se kulmin e arritur në vitin 2013.

Deficiti fiskal u ngushtua më shumë në vitin 2016 duke arritur në 1.3 % të PBB-së, në sajë të të ardhurave të shëndetshme dhe ekzekutimit me ritme të ngadalta të shpenzimeve kapitale. Kombinim i përpjekjeve të mbledhjes së të ardhurave dhe ndryshimi të politikave kontribuan në rritjen e të ardhurave tatimore me 2.3 % të PBB-së.

Rritja e normës së TVSH-së në 18 % çoi në rritje mëse të mjaftueshme të të ardhurave për të kompensuar ndikimin e hyrjes në fuqi në Prill 2016 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në, e cila reduktoi të hyrat doganore me 0.3 % të PBB-së në vitin 2016. Në anën e shpenzimeve, ekzekutimi jo i plotë i shpenzimeve kapitale të buxhetit kompensoi rritjen me 0.9 % të PBB-së të transfertave sociale; rezultati ishte një rritje në shpenzimet e përgjithshme me 1.4 % të PBB-së.

Një kontribues i rëndësishëm në rritjen e transfertave ishte rritja e numrit të veteranëve të luftës që përfituan mbështetje sociale në vitin 2016 (duke e çuar ndikimin fiskal të skemës së përfitimeve në 0.9 % e PBB-së). Për të zbutur këtë ndikim, Ligji për Veteranët e Luftës u ndryshua në fund të vitit 2016 për të vendosur një tavan mbi ndikimin vjetor fiskal të skemës prej 0.7 % të PBB-së, duke filluar nga viti fiskal 2017. Ndonëse borxhi publik dhe borxhi publikisht i garantuar është ende i ulët, ai shfaq një trend rritës, duke u rritur nga 12.9 % e PBB-së në vitin 2015 në 14.6 % në vitin 2016.⁸⁶

⁸⁶ Burimi: Autoritete e vendit, Vlerësime dhe parashikime të Bankës Botërore

Kosova	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Rritja e PBB-së reale	3.4	1.2	4.1	3.6	3.9	4.2	4.4
Përbërja (pika përqindje)							
Konsumi	2.3	3.8	2.5	4.5	2.3	3.1	2.2
Investimet	-0.1	-1.4	2.9	2.2	2.7	2.2	2
Exportet neto	1.2	-1.2	-1.3	-3.1	-1.1	-1.1	0.2
Exportet	0.4	2.9	0.5	0.9	0.6	1	1.7
Importet	0.8	-4.1	-1.8	-4	-1.7	-2.1	-1.5
Inflacioni i çmimeve të konsumit ndryshimi në përqindje	1.8	0.4	-0.5	0.3	0.6	1	1.7
Të ardhura publike	25.2	24.4	25.4	26.9	27.2	27.7	28.3
Shpenzime publike	28.1	27	27.3	28.2	29.7	30.6	31.2
Prej të cilave							
Shpenzime për paga	7.8	8.7	9	9.1	9.2	9.3	9.3
Asistencë sociale	4.2	6.1	6.9	7.3	7.2	7	7
Shpenzime kapitale	10	7.4	7	7.4	8.6	9.4	10
Bilansi fiskal	-2.9	-2.4	-1.7	-0.9	-2.1	-2.4	-2.4
Bilansi primar fiskal	-2.7	-2.4	-1.7	0.9	-2.1	-2.4	-2.4
Borxhi publik	8.9	10.4	12.7	14.3	17.2	19.6	21.3
Borxhi publik dhe i garantuar	8.9	10.6	12.9	14.6	17.6	20.1	22
Prej të cilit i jashtëm							
Exportet e mallrave	5.5	5.8	5.6	5.1	5.1	5.1	5.3
Importi mallrave	42.9	42.8	42.1	43.4	44	43.3	44.2
Exportet neto të shërbimeve	6.4	5.9	6	6.1	8	8	8.3
Bilansi tregtar	-31.5	-30.9	-30.4	-30.3	-30.9	-30.1	-29.5

Fluksi hyrës i remitancave	11	10.9	10.8	11.6	11.8	12.1	12.4
Bilansi i llogarisë korrentë	-7.2	-9.1	-10.4	-11.5	-12.5	-13.3	-12.9
Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte	5.3	2.7	5.4	4	4.4	4.6	5.7
Borxhi i jashtëm public	30.2	31.2	33.5	33.7	35.3	36.9	37.7
Rritja reale e kreditimit privat	1.9	3	7.3	10.4	0	0	0
Kreditë me probleme	8.7	8.5	6.2	4.7	4.2	3.9	3.5
Norma e papunësisë	30	35.3	32.9				
Norma e papunisë e të rinjëve	55.9	61	57.7				
Shkalla e pjesëmarrjes të të rinjëve	40.5	41.6	37.6				
PBB-ja për frymë	3.811.20	4.053.60	3.559.20	3.641.60	3.737.60	3.840.70	3.953.30

Ritmet e rritjes ekonomike u ngadalësuan në 2.4 % në vitin 2016 pasi pasiguria politike shkaktoi një rënie të investimeve private. Rritja ekonomike në 2017-19 parashikohet të jetë mesatarisht 3.3 %, nëse shuhen pasiguritë politike dhe rivendoset besimi.

Stimuli i konsiderueshëm fiskal dhe tkurrja e forces së punës quan në reduktimin e papunësisë. Mos-realizimi i shpenzimeve kapitale ngushtoi deficitin fiskal në vitin 2016, edhe pse shpezimet korrente vazhduan të rriten. Borxhi publik dhe publikisht i garantuar arriti në 48 % të PBB-së.

Stimulimi i besimit dhe rritjes ekonomike do të kenë nevojë për angazhim në konsolidim fiskal dhe reforma strukturore të mjedisit të biznesit, arsimit, dhe menaxhimin e investimeve publike. Pasiguria politike ndikoi negativisht në ritmin e rritjes ekonomike në vitin 2016, duke e ngadalësuar atë në 2.4 % nga 3.8 % në vitin 2015.

Faktori kryesor shtytës i rritjes ekonomike ishte konsumi familjar, i cili kontribuoi me 3 pikë përqindje (pp), i mbështetur nga rritja në punësim, paga, pensione, dhe kreditime për individë. Konsumi relativisht i pandryshuar i qeverisë kontribuoi vetëm me 0.2 pp në rritjen ekonomike.

Shqetësimi në lidhje me situatën politike ndikoi negativisht investimet, të cilat u tkurrën me 4.3 përqind në krahasim me vitin 2015 dhe kontribute negative me 1.4 pikë përqindje në rritjen ekonomike të vitit 2016, pavarësisht investimeve të konsiderueshme në rrugë. Eksportet neto kontribuan pozitivisht me 0.7 pp në rritjen ekonomike, pasi bilanci tregtarë të mirave dhe shërbimeve, të mbështetura nga rritja në shërbimet e IT dhe transporteve, rezultuan me suficite të vogla.

Rritja në vitin 2016 u mbështet kryesisht nga sektori i ndërtimit, ndërsa prodhimi industrial pësoi rënie. Ndërtimi u rrit me 18.5 % nga viti në vit (v-m-v) dhe kontribuoi me 2 pp në rritjen ekonomike, e mbështetur kryesisht nga tre projektet e autostradave të financuara me fonde publike. Ndërkohë, prodhimi industrial ra me 2.2 % , duke zbritur 0.2 pikë përqindje nga rritje ekonomike, pasi industritë më tradicionale vendase si miniera dhe gurorë, industria e ushqimit, veshjeve, energjia elektrike dhe furnizimi me gaz, dhe prodhimi i metaleve bazë dhe produkteve minerale jo-metalore, të cilat përbëjnë më shumë se gjysmën e prodhimit industrial, shënuan rënie në krahasim me vitin 2015. Deficiti fiskal në vitin 2016 u reduktua, kryesisht për shkak të mos-realizimit të shpenzimeve kapitale.

Deficiti ra në 2.6 % të PBB-së, që është shumë më i ulët se niveli 4 % i parashikuar në rishikimin e dytë të buxhetit. Rënia lidhet kryesisht me një ekzekutim të ulët të shpenzimeve kapitale në kontekstin e një cikli të zgjatur zgjedhor. Totali i të ardhurave ishte 27.9 % e PBB-së, me 0.9 pp rënie nga viti 2015, kryesisht për shkak të tatimit më të ulët mbi të ardhurat personale dhe kontributeve të lidhura me vendet e punës të krijuara që janë të përjashtuara nga tatimi.

Rënia e të ardhurave u shoqërua me një rënie edhe më të fortë prej 1.77 pp të shpenzimeve. Megjithatë ndryshimi në strukturën e buxhetit e bën atë më pak të qëndrueshëm: realizimi shumë i ulët i shpenzimeve kapitale tani kombinohet me shpenzimet korrente që tejkaluan 90 % të shpenzimeve të përgjithshme publike.⁸⁷

⁸⁷ <http://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/south-east-europe-regular-economic-report>

Maqedoni	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Rritja e PBB-së reale	2.9	3.6	3.8	2.4	2.8	3.3	3.3
Përbërja							
Konsumi	1.4	1.6	3	3.1	2.5	2.1	2
Investimet	0.1	3.8	0	-1.4	0	0.7	1.1
Exportet neto	1.3	-1.7	0.7	0.7	0.3	0.4	0.7
Exportet	2.6	8.2	2.4	5.9	4.3	4	3.9
Importet	1.3	9.9	1.7	5.2	4	3.6	3.2
Inflacioni çmimeve të konsumit	2.8	-0.3	-0.3	-0.2	0.6	1.4	1.5
Të ardhura publike	30.2	29.8	30.5	30	30.3	30.3	30.5
Shpenzime publike	34.2	29.8	30.9	30	35.5	33	32.6
Prej të cilave							
Shpenzime për paga	7.2	7	6.9	6.9	6.8	6.8	6.3
Asistencë sociale	14.5	14.9	14.8	14.5	14.8	14.2	14.3
Shpenzime kapitale	4.4	4.3	4.4	3	4.1	4.2	4.3
Bilansi fiskal	-3.9	-4.2	-3.6	-2.6	-3.2	-2.7	-2.3
Bilansi primar fiskal	-2.9	-3.2	-2.3	-1.5	-1.9	-1.4	-0.8
Borxhi publik dhe borxhi i garantuar	40.5	45.9	46.4	47.7	50.6	52.5	55.5
Prej të cilëve i jashtëm	25.5	31.9	31.3	33.3	34.7	35.9	37.2
Exportet mallrave	29.2	32.4	33.5	34.3	34.2	34.3	34.5
Importi i mallrave	52	54.1	53.6	53.1	54.5	54.6	54
Exportet neto të shërbimeve	29.2	32.4	33.5	34.3	34.2	34.3	34.5
Bilansi tregtar	52	54.1	53.6	53.1	54.5	54.6	54.6
Fluksi hyrës i remitancave	4.6	4.2	3.8	4	4.2	4.5	4.6
Bilansi i llogarisë korrente	-18.3	-17.6	-16.4	-14.7	-13.6	-12.2	-11.5
Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte	2.2	2.2	2.1	2.1	2	2	1.9
Borxhi i jashtëm	-1.6	-0.6	-2	-3.1	-3	-2.7	-2.1

Rritja reale e kreditim privat	2.8	2.3	2.3	3.6	2.5	2.7	2.9
Norma e papunësisë	64	70	69.4	74.1	74.7	75.1	73.8
Norma e papunësi të të rinjëve	29	28	26.1	23.7	22	20.2	19.4
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës	37.2	37.3	57	56.8	56.	56.7	56.9
PBB-ja për frymë	12.468	12.938	13.360	13.583	13.956	14.355	14.814
Norma e varfërisë	34.3	33.6	32.6	31.7	30.5	23.9	

Përfundimi

Konkluzionet dhe rekomandimet kanë rëndësi të veçantë në një punim. Për të arritur synimin e punimit si dhe për të nxjerrë konkluzione të qarta, metodologjia e kërkimit do të përfshijë burimin nga kërkimi sekondar. Fillimisht punimi do bazohet në literaturën që ekziston për ndërmarrjet e vogëla dhe të mesme.

Qëllimi është që të jepet informacion se çfarë janë ndërmarrjet e vogëla dhe të mesme. Gjithashtu, literatura dhe studimet e autorëve të tjerë do na ndihmojnë të përcaktojmë se cilët janë modelet kryesore që janë përdorur në hapjen dhe financimin e këtyre ndërmarrjeve. Në nxjerrjen e konkluzioneve të këtij punimi rëndësi të madhe do ti kushtohet kërkimit sekondar duke realizuar një model statistikor për problematikën e studiuar në punim.

Për ndërtimin e modeleve të analizës së ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme në Rajonin e Pollogut do të merren të dhëna nga njësitë tregtare që do ti analizojmë. Në kete pjese jamë munduar për ti identifikuar qartë biznesin e vogël dhe të mesëm veqanarisht pasi që NVM ka rëndësinë me të madhe në zhvillimin ekonomik si kotribuesi me i madhë në te gjitha sferat ekonomike te nje shteti pra edhe tek ne në Republikën e Kosoves si vend ne tranzicion mund te themi se NVM eshte pjesa më vitale e zhvillimit te shtetit dhe mirëqenies sociale. Gjatë kësaj pjese do te analizohen specifikat dhe rëndësia e BVM në ekonominë kombëtare si dhe rëndësia vitale qe te zhvillohet BVM.

- Përkufizimi I biznesit te vogël dhe te mesëm nga autoret dhe vendet e ndryshme
- Qasjet e ndryshme ne perkufizimin e BVM dhe domethëniet e tyre.
- Specifikat e biznesit të vogël dhe të mesëm në kuptim te zhvillimit dhe manaxhimit.
- Rëndësia e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në ekonominë nacionale.

Nuk ka pajtueshmëri rreth asaj se cilat janë kriteret qe e percaktojne nje ndermarrje apo biznes për të qenë i vogël apo i mesëm mirpo disa nga karakteristikat që e bëjnë të dallojnë bizneset nga njëri tjetri janë shumë lehtë për tu vënë re.

Duke bërë krahasime të tilla mund të themi se nuk është e njëjtë krahasimi me faktorët krahasues për të gjitha shtetet ngase ajo që është e vogël në një industri për nga vëllimi i shitjeve, për nga numri i punëtorëve, për nga të ardhurat financiare vjetore (psh. Gjermania) mund të jetë e madhe në një industri tjetër (psh. Kosova) pra në mes të këtyre ekstremeve ekziston një pajtueshmëri për faktin se qka është biznes i vogël, i mesëm apo i madhë për nga aspekti i

madhësisë. Një nga përkufizimet e BVM është dhënë nga ‘Committee for economics development’ ku jepen karakteristikat që duhet të i posedoj një biznes për të hyrë në këtë mes e ato janë:⁸⁸

Menaxhmenti i firmës është i pavarur dhe zakonishtë menaxherët janë njëkohësisht edhe pronarë.

Kapitali është pronësi i një individi apo një grup individësh

1. Regjioni i shtrirjes është kryesishtë i vogël, ndërsa të punsuarit dhe pronarët zakonishtë janë nga i njëjti rajon. Mirëpo tregu nuk do të thotë të jetë lokal.
2. Madhësia relative e biznesit në korniza të industrisë patjetër duhet të jetë e vogël kur krahasohet me bizneset më të mëdha në atë rajon. Kjo mund të jetë paraqitur në terme si madhësia e shitjes, numëri i të punësuarve ose një numër i madhë krahasimesh të rendesishme. Është e qartë se gjatë përkufizimit të BVM duhet të merren parasysh më shumë kritere të cilat mund të ndihmojnë më shumë në përkufizimë.

Si kritere tjera që ndihmojnë më shumë në këtë përkufizim mund të cilësohen edhe:

- Biznesi duhet të jetë i pavarur
- Biznesi nuk duhet të jetë dominantë në rajonin në të cilin vepron
- Numri i të punësuarve
- Të hyrat nga shitja.

Në vendet europiane duke e marrë si kriter numërin e të punësuarve mund të japim disa përkufizime të madhësive së bizneseve, psh në Francë mund të definohet kështu:

- Më pak se 10 punëtorë ndërmarrja konsiderohet si shumë e vogël (mikrondërmarrje)
- Prej 10 deri në 49 të punësuar konsiderohen si ndërmarrje të vogla
- Prej 50 deri në 500 të punësuar janë ndërmarrje të mesme dhe
- Me shumë se 500 të punësuar janë ndërmarrje të mëdha

Poashtu edhe në Itali kriteret kryesore të definimit të bizneseve janë: numri i të punësuarve, qarkullimi, kapitali fiks, pjesëmarrja në treg etj. Duke marrë për bazë numrin e të punësuarve në Itali bizneset ndahen në:

- Prej 1 deri në 19 të punësuar konsiderohen si mikro-ndërmarrje
- Prej 20 deri në 99 të punësuar konsiderohen si ndërmarrje të vogla

⁸⁸ Muhamet Mustafa, Enver Kutllovci, Petrit Gashi, Besnik Krasniqi- ‘Biznesi i vogël dhe i mesëm’, Prishtinë 2006 Fq.19

- Prej 100 deri në 499 të punësuar konsiderohen si ndërmarrje të mesme dhe
- Më shumë se 500 të punësuar konsiderohen si ndërmarrje të mëdha

-Edhe në Gjermani duke e marrë për kriter numrin e të punësuarve NVM mund te ndahen:

- Prej 1 deri në 49 të punësuar ndërmarrja konsiderohet si e vogël
- Prej 50 deri në 499 të punësuar ndërmarrja konsiderohet si e mesme dhe
- Mbi 500 të punësuar ndërmarrja konsiderohet si e madhe

-Poashtu edhe Banka Botërore jep përkufizimin e vetë sa i perket klasifikimit te ndërmarrjeve duke marre si faktor krahasues numrin e të punësuarve:

- Prej 1 deri në 5 të punësuar konsiderohen si mikrondërmarrje
- Prej 6 deri në 25 të punësuar konsiderohen si ndërmarrje të vogla
- Prej 25 deri në 249 të punësuar konsiderohen si ndërmarrje të mesme dhe
- Prej 250 e më shumë të punësuar konsiderohen si ndërmarrje të madhe

Ndërsa Bashkimi Europian jep përkufizimin e vet sa i perket klasifikimit te ndërmarrjeve duke marrë në konsiderat numrin e të punësuarve dhe poashtu edhe Republik e Kosoves klasifikimin e vet për ndërmarrjet e bën ndarjen e cila praktikohen nga BE dhe kjo ndarje perdoret ne institucionet në Kosove dhe ky klasifikim eshte si më poshtë:

- Prej 1 deri në 9 të punësuar konsiderohen si mikrondërmarrje
- Prej 10 deri në 49 të punësuar konsiderohen si ndërmarrje te vogla
- Prej 50 deri në 249 të punësuar konsiderohen si ndërmarrje te mesme dhe
- Prej 250 e më shumë të punësuar konsiderohen si ndërmarrje të mëdha.

Pasi qe nuk kamë mundur te gjejë të dhëna me te reja ne lidhje me numrin e bizneseve në Kosovë dhe krahasimin e tyre per nga numëri i punëtorëve atëherë jamë detyruar të marrë për bazë një hulumtim te kryer nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë / Departamenti i Politikave të Zhvillimit të Sektorit Privat të vitit 2013 si raportin me te ri qe kamë mundur ta gjejë sa i perket kesaj sfere.

Ekzistojnë dallime thelbësore në mes të ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha,të cilat duhet te merren parasysh kur bisedohet për zbatimin e menaxhmentit.Kështu p.sh.ndërmarrjet e vogla kanë numër të vogël të punësuarish,madhësi të vogël të punës,numër të vogël shfrytëzuesish dhe kryesisht veprojne ne tregjet lokale.

Për të sqaruar dallimet në aplikimin e menaxhmentit në ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha, është e nevojshme që të sqarohen disa nga karakteristikat plotësuese të ndërmarrjeve të vogla të cilat i dallojnë nga ndërmarrjet e mëdha. Ato janë:

- Marrja më e shpejt e vendimeve
- Fleksibiliteti më i madh
- Centralizimi më i vogël gjatë marrjes së vendimeve, strukturë organizative e thjeshtë
- Ndikim i madhë i pronarit, komunikim i drejtpërdrejtë prej lartë-poshtë
- Planifikim formal i thjeshtë dhe fleksibil
- Participim i kufizuar i të punësuarve në vendimmarrje, më pak nivele të menaxhimit

Inovacionet janë ndër karakteristikat thelbësore të cilat edhe mund të percaktojnë qëndrueshmërinë apo jo në treg të ndërmarrjes. Ndërmarrjet e vogla përfaqësojnë deri në një shkallë burimin natyror të një stili alternativ të punës në shoqërinë burokratike, e cila siguron kanale jashtë institucionale të kreativitetit.

Ndërmarrjet e vogla shpesh janë burim i materialeve të reja, proceseve, ideve, shërbimeve dhe prodhimeve ndërsa ndërmarrjet e mëdha përmes tyre pastaj i sigurojnë të njëjtat. Ndërmarrjet e vogla janë të ndikuara të jenë inovative me qëllim që të sigurojnë konkurrencë në treg. Pavarësisht nga kompleksiteti dhe shpenzimet e nevojshme për kërkime, ndërmarrjet e vogla kanë bërë më shumë se gjysmën e zbulimeve (shpikjeve) në vitet e fundit.

Punësimet e reja në tregjet e gjdo shteti konsistojnë me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kërkimet në SHBA, Kanada, dhe Europë tregojnë se numri më i madh i mundësive për punësim krijohet nga NVM-të. Këto hulumtime tregojnë mundin dhe kontributin e madhë që bëjnë këto ndërmarrje për ekonominë kombëtare të shteteve ku veprojnë. Në vitet e 80' dhe 90' këto ndërmarrje kanë krijuar mbi 80% të punësimeve të reja të vendeve të punës.

Fleksibiliteti është poashtu karakteristika nga më kryesoret të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Fleksibiliteti nënkupton aftësi të NVM-ve që ti ndërroj aktivitetet dhe të reagoj shpejt në ndryshimet e tregut. Në anën tjetër fleksibiliteti nënkupton ndërmarrje të veprimit të shpejtë korrigjuese-përmisuese të vendimeve të marrura. Fleksibiliteti mund të sillet në madhësinë çmimit, asortimentin etj. Fleksibiliteti mund të ndikojë edhe në ndryshimet e veprimtarisë së NVM-ve. Në kuptimin përmbajtësorë fleksibiliteti nënkupton ndërrim të aktiviteteve në dritën e ndryshimeve të kushtueshme të tregut dhe përshtatje të shpejtë të kapacitetit të ndryshimeve të kërkesës.

Marëdhëniet direkte gjatë punës janë poashtu një karakteristik specifike për ndërmarrje e vogla dhe të mesme. Pronari-menaxheri ka marëdhënie interne të afërta me të punësuarit dhe marrëdhënie direkte eksterne me konsumatorët, furnitorët dhe bankat

Menaxhimi nga një person është poashtu specifik e këtyre ndërmarrje pasi që siq u theksua më lartë këto tipe të ndërmarrjeve nuk kanë nivele hierarkike të mëdha të menaxhimit sikurse që kanë ndërmarrje e mëdha. Në fazën fillestare të zhvillimit të BVM, të shumtën e rasteve menaxhmenti zbatohet nga një person. Pronarët-menaxherët e këtyrë kanë njohuri të përgjithshme, disponojnë me autoritet të pakufizuar dhe përgjegjësi në drejtimin e ndërmarrjeve. Gjithashtu menaxherët-pronarët të këtyre ndërmarrjeve i marrin të gjitha vendimet strategjike dhe taktike që janë të lidhura me zhvillim dhe punësim.

Kapitali i kufizuar është karakteristik e cila konsiderohet si e metë në fazën fillestare të zhvillimit të ndërmarrjes. Bëhet fjalë për asete të kufizuara të xhiros që përdoren për mirëmbajtjen e paisjeve, financimin e furnizimeve me lëndë të pare, financim të stokeve e të ngjashme.

Pavarësia është pjesa e cila sjell dobi por në të njëjten kohë mund të sjellë edhe ndëshkim në rast se nuk kontrollohet kjo lloj pavarësie. Përmes kësaj pronarët e NVM-ve kënaqen në autonominë që u mundëson të vijnë në shprehje iniciativa, shpikja dhe ambiciet.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kanë një histori shumë të gjatë, ndërsa zhvillimi i tyre është i shënuar me zgjerimin dhe stagnimin e tyre të kohë pas kohshëm. Ndoshta ekspansionin më të madh ndërmarrjet e vogla dhe të mesme e mbërrijnë në fillim të viteve të 70' të shekullit XX. Risi është se prej që atëherë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me sukses përballojnë sfidat e konkurrencës dhe të globalizimit.

Ndonse një pjesë e vogël e këtyre ndërmarrjeve bazohet në teknikën dhe teknologjinë tradicionale, pjesa më e madhe e tyre aplikon një teknologji të re dhe të lartë si dhe një organizim modern. Thelbësore është se NVM demonstrojnë një shkallë të lartë të inovacioneve, fleksibilitetit dhe adaptim ndaj ndryshimeve, të cilat ndodhin në rrethinë. Edhe pse janë të orientuara kah tregu lokal NVM kanë rol gjithnjë e më të madhë edhe në këmbimet ndërkombetare.

Hulumtime të shumta dëshmojnë se pjesëmarrja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme rritet në raport me ndërmarrjet e mëdha. Kjo nuk do të thotë se ndërmarrjet e mëdha e humbin kuptimin. Në fakt ndërvartësia midis tyre bëhet gjithnjë e më e madhe. Rastet kur ekonomitë

nacionale arrijnë të gjejnë kombinim optimal në mes të ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha janë gjithnjë e më të mëdha.

Në literaturat ekonomike të shteteve të zhvilluara veqohen katër faktorë të kontributit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në ekonominë e tregut:

1. Kontributet në proceset e ndryshimeve teknologjike
2. Kontributi në sjelljen e konkurrencës së shëndoshë
3. Hapja e vendeve të reja të punës
4. Oferta e pasur e prodhimeve në tregun vendor

Këtu duhet shtuar edhe faktin se zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme kontribuon edhe në vendet e tranzicionit në ngjalljen e iniciativës ndërmarrëse në ndryshimin e strukturës ekonomike si dhe funksionimin më harmonik të ekonomisë në përgjithësi. Megjithatë prej të gjithë këtyre kontributeve rëndësi më e madhe i kushtohet punësimit në të cilin ndërmarrjet e vogla dhe të mesme zënë një vend të madh⁸⁹.

⁸⁹ Muhamet Mustafa, Enver Kutllovci, Petrit Gashi, Besnik Krasniqi- 'Biznesi i vogël dhe i mesëm', Prishtinë 2006 fq.22-25

Bibliografia

- 1) AbdylMenaf Bexheti, Financat Publike, Tetovë, 2007
- 2) Efektet e refromave tatimore në performanën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në komunën e Tetovës dhe Gostivarit, Prof. Dr Rufi Osmani, Tetovë, 2009
- 3) Fossati A., and Levaggi R., Dal Decentramento alla Devolution: I Federalizmo Fiscale in Italia e in Europa. Ferraro Angeli, Milano 2001.
- 4) Атанасовски, Живко: Јавни финансии, Економски Факултет, Скопје, 2004
- 5) Тодевски, Димитар: Карактеристики на јавните финансии на Македонија, Скопје, 2006
- 6) Riinvest, 2009. Strategjia e industrisë. Prishtinë: Instituti Riinvest.
- 7) Rukiqi, B., 2011. Zhvillimi i sektorit privat. [Intervistë]. (Komunikim personal, Maj 2011).
- 8) Shahini, A., 2011. Zhvillimi i sektorit privat. [Intervistë]. (Komunikim personal, Maj 2011)
- 9) Aran Bryman, Emma Bell, Business research methods, Second edition, Oxford University Press, 2007
- 10) Masterman, M. The Nature of Paradigms. In Criticism and the Growth of Knowledge, eds I Lakatos and A Musgrave, Cambridge University Press 1970.
- 11) G. Burrell and G. Morgan, Sociological paradigms and organisational analysis, The Chaucer Press, 1979
- 12) G. Johnson, K. Scholes, R. Whittington, Exploring Corporate Strategy, Prentice Hall
- 13) Ciaran Mac an Bhaird, Resource Small and Medium Sized Enterprises, Physica-Verlag, 2010
- 14) John Kuada, Paradigms in International Business Research – Classification and Applications, No. 52, 2009
- 15) Ayyagari, M., & Demircuc-Kunt, A., & Maksimovic, V. (2011). “Small vs. Young Firms Across the World: Contribution to Employment, Job Creation, and Growth”, Policy Research Working Paper Series 5631, The World Bank
- 16) Audretsch, D. B., and Klepper, S. (2000). “ Innovation, Evolution of Industry and Economic Growth: Elgar reference Collection”, International Library of Critical Writings in Economics, Cheltenham, UK

- 17) Deakins, D., North, D., Baldock, R., and Whittam , (2008). "SMEs Access to Finance: Is Still Finance Gap?", Institute for Small Business & Entrepreneurship. Vol. 3 pp 11-19
Available at: <http://www.isbe.org.uk/content/assets/BP08-Davi Deakins. Pdf>
- 18) EU SME 2012: " At the Cross Road, Annual Report on Small and Medium –Sized in the EU", 2011/2012, Client: European Commission, Rotherdam)
- 19) Fatoki, O., & Asah, F. (2011). The Impact of Firms characteristics on Access to Debt finance by SMEs in King Williams' Town, South Africa", International Journal of Business and Management, vo. 6, no. 8
- 20) Klapper, L., Sarria-Allende, V. & Sulla, V. (2002). " SME Financing in Eastern Europe", Washington D. C.: World Bank, Development research group Ministria e Tregtise dhe Industrise -PZSHP (2006)
- 21) UNCTAD, (2001). "Survey of Good Practice in Public- Private Sector Dialogue", Enterprise Development Series, New York, and Geneva: United Nation
- 22) Tmava, Q. (2014) "Roli i Bankave në Menaxhimin e Investimeve në NVM-të në Kosovë"
Dorëshkrim doktrate në UP
- 23) RIINVEST, (2012). " Sektori bankar: Ndihmesë apo barierë", Prishtinë